REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më-Dana: 18-03-2026 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. Fortganit Org. Jed. | Numri Broj | Shtojca Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 060 | /01- | 355 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës se Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **IV** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **30.03.2026, (e hënë),** duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës se veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2026.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien ne shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit**për **shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-277, të datës 02.03.2026 për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me nr. 1088-0 me sipërfaqe 17758 m$^2$në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla" e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e Qerdhes dhe parcela në të cilën do të ndërtohet Qerdhja do të jete parcela nr 1088-2 me sipërfaqe 4000 m$^{2.}$**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Deklaratës mbështetëse për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.**
7. **Pyetje dhe përgjigjeje**

**Viti,më18.03.2026**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Piku 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES SË TRETË TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesuesi i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 27.02.2026 (e premte), në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës z.Hasan Aliu, drejtorët komunal, mediat elektronike, këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Faruk Shabani, znj.Yllka Qamili, znj.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, znj.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, zn.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, z.Labinot Bislimi, z.Elham Emërllahu, ndërsa mungoi z.Sokol Shaqiri, z.Bekim Rama, z.Visar Demiri. znj.Liridona Bislimi, z.Remzi Salihu.

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë. Kjo është seanca e tretë e Kuvendit Komunal të këtij mandati. Materialin e keni marrë me kohë për këtë séance, dhe pak para se me fillu këtë pjesë, po ju njoftoj se, kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë për të gjitha vendimet. D.m.th janë të gjitha në rregull. Vazhdojmë me rendin e ditës. Pikë të fundit e kemi pyetje dhe përgjigje.

## Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit Komunal.**
2. **Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2025.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët do të përfaqësojnë Komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete, projekt i realizuar në vitin 2025, dhe 20% e participimit të fermerëve përfitues në mekanizëm bujqësor dhe serra nga subvencionet për vitin 2026.**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-2, me sipërfaqe 17758 m$^2$, në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcel do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jet parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m$^2$.**

**Kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi:** Për rend të ditës a ka me diskutu? Pasi që nuk ka: a jeni që të miratohet rendi i ditës?. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit Komunal**

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** A jeni që të miratohet procesverbali? Pra, nga të gjithë të pranishmit me vota pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. **Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** Te pasqyrat financiare është obligim ligjor që, pasqyrat financiare të jepen çdo 3 muaj, por tani janë pasqyrat financiare vjetore.

**znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pasi që materialin e keni marrë me kohë, do t'i prezantoj në pika të shkurtra. Buxheti i alokuar për periudhën janar–qershor 2025, në të gjitha kategoritë ekonomike është 19 milion e 90 mijë e 931 euro, ndërsa shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike janë 18 milion e 833 mijë e 720 euro. Shpenzimet për kategorinë paga dhe shtesa janë 10 milion e 265 mijë e 171 euro apo 99.95% në krahasim me alokimet. Shpenzimet për kategorinë mallra dhe shërbime janë 3 milion e 177 mijë e 362 euro. Shpenzime për shërbime komunale 293 mijë e 202 euro. Shpenzime për subvencione 846 mijë e 347 euro. Shpenzimet për investime kapitale 4 milion e 301 mijë e 636 euro. Në pasqyrat financiare keni të prezantuar buxhetin e aprovuar dhe të alokuar për të gjitha programet buxhetore. Zyra e kryetarit ka shpenzuar 99.17%. Administratë dhe personeli 98.92%. Inspeksioni ka shpenzuar 99.74%. Zyra e kuvendit 99.87%. Shpenzimet publike 99.40%. Buxhet dhe financa 96.46%. Zyra e komiteteve 100%. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim 99.24%. Gjeodezi kadastër 96.98%. Planifikimi urban 100% dhe shëndetësia 99.80%. Shërbimet sociale 98.81%. Kulturë, rini dhe sport 99.72%. Arsim dhe shkencë 99.98%. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar–qershor 2025: të hyrat e planifikuara për vitin 2025 janë 1 milion e 270 mijë e 127 euro dhe të hyrat e realizuara për periudhën janar–dhjetor janë 1 milion e 567 mijë e 205 euro apo në përqindje realizimi duke u bazuar në planifikim vjetor është 123.39%. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar–dhjetor 2025 me të hyrat janar–dhjetor 2024: të hyrat 2025 janë 1 milion e 567 mijë e 205, ndërsa në 2024 kanë qenë 1 milion e 233 mijë e 358 euro. Të hyrat e vitit 2025 janë më të larta për 333 mijë e 847 euro. Prezantimin analitik të investimeve kapitale për periudhën janar–dhjetor 2025: gjatë kësaj periudhe shpenzimet nga investimet kapitale janë 4 milion e 301 mijë e 636.62 euro, por që i keni të paraqitura edhe në material. Vlen të theksohet se nga shuma totale 2 milion e 556 mijë e 634 euro janë të ekzekutuara nga komuna e Vitisë për projektet që kanë të kryera në terren dhe në situatë të pranuara nga organi mbikëqyrës, ndërsa 1 milion e 735 mijë e 2 euro janë të ekzekutuara nga thesari që këto shpenzime janë obligime të viteve të mëhershme nga kontrata kolektive. Krahasimi i shpenzimeve për periudhën janar–dhjetor 2025 në të njëjtën periudhë të vitit 2024: shpenzimet e vitit 2025 krahasim me vitin 2024 janë më të ulëta për 992 mijë e 32 euro. Dhe në fund i keni të prezantuara obligimet dhe të hyrat e bartura të vitit 2026. Obligimet e bartura nga të gjitha kategoritë ekonomike janë 4 milion e 576 mijë e 563.21 euro, ndërsa të hyrat vetanake që barten për shpenzimet e vitit 2026 janë 303 mijë e 355.75 euro.

**z.Basri Aliu:** Përshëndetje për të gjthë të pranishmit. Shfrytëzoj rastin të ja uroj muajin e shenjtë të Ramazanit të gjithë besimtarëve musliman, dhe ju dëshiroj agjërim të lehtë. Sa i përket pasqyrave financiare, ne e dimë se, këto pasqyra tregojnë vetëm shpenzimin e buxhetit gjatë vitit 2025, prandaj këtu në realitet të te cilit janë paraqitë, këtu paraqesin një shpenzim kogjo të mirë të buxhetit. E di që ekzekutivi ka pas telashe lidhje me buxhetin për vitin 2025, sepse kontrata kolektive ju ka paraqit edhe telashe në ekzekutim të këtij buxhteti, por si përfundim i kësaj, dhe të hyrat vetanake janë të realizuara mire. Mendoj që ky buxhet është shpenzuar në maksimumin e mundshëm.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. E para e punës është një vërejtje për mos pranimin e kamerave apo kontratës që nuk ka transmetim publik të seancës dhe e dyta që në seancën e kaluar nuk kam qenë, du me fol pak për këtë pjesën që the pika e 8 se nuk është pika pyetje dhe përgjigje po është debat politik, më së pari kuvendi është arenë politike nuk është çështje teknike dhe qytetari është organi më i lartë në nivel vendi, në kuvendin e Kosovës ndërsa në nivel lokal organi më i lartë është kuvendi komunal tash kushdo që e

ka bë këtë rotacion tregon që nuk e ka fijen as merzinë e gajlen e qytetarit por e ka qaty çështje teknike ta kryem e të hecim e kemi bë teknik edhe kuvendin e kjo është e ulët, më së pari krejt këta kuvendar këtu çka janë votu prej qytetarëve tregon që nuk është kurgja as qytetari që të ka votu as ti që je ardh këtu, vendos dikush që nuk është për këtë punë, këto janë punë të ndara legjislativi është atje kuvendi është këtu, atje është diçka tjetër këtu fjalën e ka qytetari dhe kjo që e keni kthy këtë punën e pyetjeve përgjigjeve që edhe kështu nuk duhet me quajt po duhet me quajt debate parlamentare që keni qitë pjesën e fundit është e ulët se nuk rri kërkush në atë pjesë se veç i kryen disa punë dhe hecë nuk i intereson. Ndërsa te pasqyrat financiare te shpenzimet kapitale realisht shpenzimet kapitale janë 96.77% ndërsa këtë vitin 2025 që lam nëse e dinë sa pare i ka marrë kontrata kolektive dhe proceset tjera gjyqësore që disa si dimë e disa ndoshta nuk i paraqisni këtu për shkak se kur ta kqyrsh aty flitet për miliona që janë marrë prej kontratës kolektive ndërsa për realizimin thotë që është 96% qysh ka mundësi, obligime ki mos vetë qysh ka mundësi me t'i marrë prap prej këtij kodi shembull u ndala vetëm te kapitalet me i marrë 50-60% të parave dhe realizimi mu bë 96% kjo nuk është logjikë kjo është keq regjistrim. Një pyetje te faqja 28 kodi 1344 shërbime këshilldhënëse dhe profesionale në vitin 2024 kanë qenë 154 mijë e 427 euro ndërsa në vitin 2025 510 mijë e 352 euro diferencë, ne e kemi kështu se ne e dimë se çka u bë po mu sqaru këshilldhënëse dhe profesionale çfarë këshilla a është institut ky apo çfarë punë ka komuna çfarë projekte ka komuna. Ndërsa faqe 24 kolona 27 hartimi i projekteve konsultim 19 mijë euro, tash janë 3 kontrata të nënshkruara prej 2021 deri me 2026 a është kjo faturë prej njërës prej këtyre kompanive kanë qenë po e ceku me emër tash Florent Emini i cili për 5 vite i bje mi marrë diku 844 mijë për me i bë projekte komunës veç nalnu menoni 1 milion euro mi bë projekte komunës se di çfarë projekte kemi pas se di a kemi pas projekte a jo. Ndërtimi i palestrave sportive shkollore kuvendi i Lezhës në Viti dhe shkolla fillore Sllatinë e Epërme këtu figuron Euro Komerc ndërsa më herët pata dokumente që është Nika projekt në Sllatinë dhe Euro Komerc në Viti ndërsa këtu kemi për të dyja këtë Euro Komercin a janë dy kompani që punojnë a është një, apo është e një njerit sikur që na ka rastis me thirrë dikë në telefon për një projekt në Viti dhe dilke që numri i telefonit është i kompanisë e cila e ka konkurent kompaninë tjetër do të thotë dy kompani me një numër të telefonit. Obligimet e pa paguara këtu te investimet kapitale janë 2 milion e 752 mijë e 72 euro ndërsa te buxheti i alokuar për këtë vit investime kapitale i kemi 3 milion e 365 mijë e 71 euro, tash nuk po them që nuk ka telashe edhe në Viti dhe gjithë Kosovën me këtë kontratën kolektive por po më duket që nuk jemi serioz te kjo puna e obligimeve të kryme se këtu është interesant me hi kompanitë kush ka marrë pare kush jo se gabim shumë i madh duhet me u bë për me i nxjerr paret njerëzit që kanë punu e tash kur t'ia heksh këtë 2 milion e 752 mijë që janë obligime te kapitalet po flas jesin vetëm 613 mijë euro për investimet kapitale. Mos harroni tash ligji është mbi të gjitha një faturë që nuk paguhet 1 muaj fillon me 8% kosto shtesë veç për 1 muaj tani veç vinë tu u rritë jashtë krejt kësaj që komuna e Vitisë është në vitin e dytë apo të tretë që nuk ka planifikim të projekteve të parasë unë kam tabela kështu shabllon dmth në vitin e kalum kam folë për 27 projekte të cilat e kanë kalu çdo dinamikë të punës janë të stërpërsëritura e tash po më intereson për vitin 2025 a ka pasë ndonjë projekt të ri që është i nënshkrum që është i fillum 2025 që është i planifikum për 2025 edhe që është i realizum apo që është në realizim dmth nuk është veç faji te kontrata kolektive po tash na kemi shumë gjëra që nuk i kemi më në dorë kanë dalë prej sistemit krejt, kur të hish te përmbaruesit është e çuditshme se si Komuna e Vitisë asnjëherë nuk ka dalë me folë as me kajt një dert me neve se çka bajmë bile me këta që me pshtu paren ka kalu ajo sikur diçka që nuk ki çka i banë.

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** Besoj që kontrata për transmetim pas miratimit të buxhetit, do të fillon procedura, se nuk ka mujt për shkak të buxhetit, se ka skadu në tetor kontrata, dhe besoj që kjo hyn në procedurë, ndërsa pika për pyetje përgjigje, dhe në rregullore është pyetje përgjigje, nuk është debat politik, dhe është me kërkesë të grupit të LDK-së, është votu dhe ka dalë në pjesë të fundit. D.m.th, është bërë me kërkesë dhe votim.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. E kam një vërejtje për seancën e fundit solemne që kemi mbajtë. Seanca ka fillu pa himnin e shtetit ose pa himnin kombëtar, dhe për mua ka qenë e papranushme. Unë atë ditë nuk kam dashtë me reagu, mandej kam diskutu me juve, por është totalisht absurd me fillu një seancë solemne pa himn kombëtar ose pa himnin e shtetit. A ka kontrata apo nuk ka, nuk është një çështje që na intereson. Seanca soleme mbetet seancë solemne. Kur t'i nderoj dëshmorët duhet me i nderu me himnin kombëtar, se ata e kanë dhanë jeten pikërisht me atë himn. Tek çështjet që po diskutojmë, pyetjet dhe

përgjigjet apo problematikat të cilat i kemi pas, është fat që është ndryshu. Po du me të përmirësu kryesues, nuk është ndryshu veç me kërkesë të LDK-së, por edhe me kërkesën dhe votimin e grupit të juaj të PDK-së.

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** Çdo vendim që qohet gishti për ose kundër e miraton Kuvendi ose e rrëzon Kuvendi. Momenti që votohet në kuvend, është vendim i Kuvendit, të pëlqej ty apo nuk më pelqen mua, në momentin që miratohet është vendim i Kuvendit.

**znj.Majlinda Shabani:** Kryesues, sipas teje a është më e rëndësishme kërkesa apo votimi?

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** Votimi.

**znj.Majlinda Shabani:** Votimi është bërë prej LDK-së dhe PDK-së. Duhet me i lajmru edhe qytetarët, se përderisa nuk po transmetohet seanca direct, ne prej praktikave të kalume, të paktën e kemi ditë që kur ka fillu seanca e kuvendit komunal, qytetarët krej nuk mujnë me pas qasje direkte me pa informatën që ka seancë të Kuvendit Komunal, dhe që mundohen me i shpreh problematikat që i kanë, dhe zakonisht kemi pas raste që kur është trasmetu direkt seanca e Kuvendit Komunal, aty për aty neve na kanë ardh kërkesa dhe na kanë ardh të paktën me fotografi, që ne i kemi pa ku i kanë problematikat në lagje të tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi:** Edhe ti si anëtare e Kuvendit, të vjen një fotografi prej një qytetari atje, dhe pa shku me vertetu për çka je tu fol. Veç shkon e merrë një fotografi për me fol. Për mua nuk je serioz.

**znj.Majlinda Shabani:** Dua të jem shumë e qartë këtu, sepse pyetjet dhe përgjigjet që i kemi për problematikat e qytetarëve është çështja e parë që na, të paktën, e kemi konsideru në interes të qytetarëve. Ka ndodh si ka ndodh situata, jemi këtu ku jemi, por në fund të sigurohemi që nënkryetari së bashku me ekzekutivin kanë me pasë durimin me qëndru deri në fund me i dëgju pyetjet dhe kërkesat. Çka po e shoh dhe çka kam mujtë me pa është që realisht këto pasqyrat financiare janë tepër zhgënjyese dhe alarmuese. Zhgënjyese për faktin dhe realitetin se ku jemi tu jetu, dhe e dyta është alarmuese për mënyrën se si është tu u shpenzu dhe trajtu paraja publike. Unë diçka që kam mujtë me pa është se secili zë buxhetor duket më i paqartë se tjetri, mundemi me thanë një kryevepër në vete. Ka mungesë transparence, ka tendencë për manipulim me shifra dhe emërtime, por diçka që shihet qartë është që buxheti i komunës së Vitisë nuk po përdoret më si mjet për zhvillimin e qytetit dhe për problematikat apo mirëqenien e qytetarëve, por shkurt e shqip është tu u përdor si mjet për mbijetesë politike të kryetarit Sokol Haliti dhe klientelave të tij. Sidomos për vitin 2025, ku është komplet buxhet i shfrytëzum për fushata politike, dhe kjo vetëm një palë zgjedhje, por dy palë zgjedhje. Diçka që dua me pyet është se, edhe pse shumë projekte figurojnë në letër, nëse dalim në terren e shohim që nuk duken fare ose janë realizu pa kurrfarë standardi. Një diçka që duhet me përmend patjetër është edhe raporti i auditimit të pasqyrave financiare, sepse dimë që ky raport vazhdimisht ka nxjerr shkelje dhe keqmenaxhim në vlera milionëshe. Dhe diçka që ka ndodh në vitin e kaluar është që ky raport i auditimit nuk ka ardhë në seancën e kuvendit komunal me u diskutu fare. Dhe një diçka duhet me pasë të qartë: transparenca nuk është zgjidhje “a doni a nuk doni” me pru, është obligim ligjor që duhet me u pru dhe me u diskutu në seancë të kuvendit komunal. Ju jeni tu dashtë me ju ikë, por nuk keni me mujtë. Diçka që kemi mujtë me pa te pasqyrat financiare janë obligimet e papaguara, ku kapin vlerën 4 milion e 576 mijë euro, ndërsa investimet kapitale janë diku rreth 4 milion e 300 mijë euro. Pra më shumë kemi obligime sesa investime reale. Kjo është e qartë që është një mënyrë e papërgjegjshme e menaxhimit të buxhetit. Një diçka tjetër që kemi mujtë me pa janë dhjetëra emërtime në investime kapitale ku figurojnë si vendime gjyqësore apo kontrata kolektive. Pra 4 milion e 300 mijë janë investime kapitale, prej tyre vendime gjyqësore, sa i llogarita unë, janë 1 milion e 730 mijë euro. Dhe pyetja ime e parë është: a janë vetëm këto vendime gjyqësore për kontrata kolektive apo ka edhe procese tjera gjyqësore prej të cilave janë marrë mjete? Diçka tjetër që dua ta përmend te vendimet gjyqësore të kontratës kolektive është se, dorën në zemër, kontrata kolektive po na pështojnë prej mënyrës se si ne po arsyetohemi. Kontrata kolektive ka qëllu, nuk kemi mujtë me i realizu investimet. Të paktën me sqaru cilin investim e keni planifiku për vitin 2025 që kontrata kolektive ja paska pamundësu juve. Aman mos ja nisni me vajtu kur të flasim për kontratat kolektive dhe vendimet gjyqësore. Qe 10 vite nuk keni mujtë me zgjidh çështjen e ujit të pijshëm, ama me lidh kontrata për shërbime këshilldhënëse dhe profesionale në vlerë milionëshe, aty kontratat kolektive nuk po preken. Vendime gjyqësore keni mujtë. Kemi pasë raste kur për çdo vit janë shpenzu miliona euro, mijëra euro vetëm për miratim të projekteve, e që kurrë nuk e dimë se ku kanë shku ato pare. Mos u mundoni me

arsyetu secilin investim që nuk është bërë për shkak të kontratës kolektive. Jeni tu e vajtu shumë dhe arsyetimi është i papranueshëm në këtë rast për mua. E dimë si është problematika, e kuptojmë shumë mirë, ama kanë shku miliona euro për çdo vit. Te pasqyrat financiare i kemi pa në shpenzime që kurrë nuk keni dhanë as përgjigje, as nuk ka pasë fare transparencë. Po ndërlidhem te kjo ku thuhet shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Kemi diskutu edhe herën e kaluar. Në fakt unë kam kërku edhe me pas një raport se çka janë këto shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Po i heki këtu 312 mijë euro që keni kontratë me Kosova Med, sepse e dimë për çka i keni lidh ato: me i rahatu këta njerëz që i keni pasë në kohë të fushatës. Ato kontrata që keni lidhë keni pasë problem, sepse e dimë që shumica e atyre që keni lidhë kanë pasë problem edhe mungesë në paga për disa muaj. Por thuhet që ka shërbime këshilldhënëse dhe profesionale në qëndrueshmëri ekonomike dhe zhvillim. Ceken disa fjali aty, ta merr mendja thua Vitia pale çka është. Pyetja ime konkrete është: cili është rezultati i këtyre shërbimeve këshilldhënëse dhe profesionale? A mundemi me ditë kush janë ata persona që janë të punësum ose që merren me këto këshillime profesionale? Diçka tjetër: për 200 mijë euro për asfaltim të rrugëve rurale vetëm për vitin 2025. Pyetja ime është se cilat rrugë janë asfaltu dhe ku janë asfaltu ato rrugë rurale. 320 mijë euro thuhet për rrugë me zhavorr – ku janë ato rrugë? Diçka tjetër ku thuhet që 254 mijë euro janë shpenzu për dru dhe produkte druri për ngrohje. Pyetja ime është se sa dru janë ble dhe cilat objekte ngrohen me dru dhe cilat objekte në komunë të Vitisë ngrohen me nxemje qendrore. Ndërsa për shpenzimet për derivate: ku konkretisht janë përdor? 41 mijë euro janë për shenja dhe vija të komunikacionit për gjatë vitit 2025. Pyetja ime është se ku janë vendos këto shenja dhe vija të komunikacionit, sepse nëse dalim me pa në qytet nuk shohim shumë rrugë që kanë vija të komunikacionit dhe rregullim të trafikut. Dua ta përmend edhe rrugën që është te shkollat e mesme, ku realisht çdo herë që kalon në atë rrugë është rrezik për nxënësit, sepse e frekuentojnë shumë atë rrugë. Investimet në trotuare – ku janë bërë këto investime? Sepse nëse dalim me pa në terren, mundem me thanë lirshëm që 70% e trotuareve që janë investu në vitet paraprake janë të dëmtume dhe jashtë funksionit. 259 mijë euro për mirëmbajtjen e rrugëve rurale – cilat rrugë janë mirëmbajtë dhe mënyra se si po mirëmbahen ato rrugë? Në moment që mirëmban një rrugë, a është investim me i mbulu gropat? Sepse në moment që dalim i shohim që ato nuk janë as të kryme e as nuk janë tu u kry, por këtu figurojnë që janë tu u bë. Tash jemi tu hi në një fazë të re të qeverisjes, është një mandat tjetër i ri. Një diçka që duhet me pa qartë është se krejt asfaltet që keni shtru vitet paraprake duhet me dalë në terren me i vizitu dhe me i pa që janë tu u shkatërru. Janë krejt me gropa, janë punime pa kurrfarë standardi dhe dëmtohen brenda një kohe shumë të shkurtë. Me përmbyll krejt këtë: diku mbi 60% e këtyre pasqyrave financiare që jam tu i diskutu nuk kanë ndikim fare të drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe në mirëqenien e tyre, sidomos në aspektin social. Edhe një gjë duhet me pas shumë të sigurt: qytetarët nuk jetojnë me tabela financiare. Jetojnë me rrugë funksionale, me trotuare të sigurta dhe me hapësira të gjelbërta. Dhe dua ta di: këtu thuhet se janë shpenzu 100 mijë euro për hapësira të gjelbërta. Nuk e di se ku janë bërë ato hapësira, veç nëse kanë shku te ato mbindërtimet që janë tu u bë në Viti. Përndryshe, hapësira të gjelbërta nuk kemi askund. E kemi një kënd të lojërave te parku këtu në Viti që nuk është investu as edhe një cent në atë park, e kënej thuhet që jemi tu investu në hapësira të gjelbërta 100 mijë euro.

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Po filloj tek shpenzimet buxhetore. Buxheti i alokuar për periudhën janar–dhjetor nga të gjitha fondet burimore, granti qeveritar dhe të hyrat vetanake dhe donacionet janë 19 milion e 90 mijë e 931 euro, ndërsa shpenzimet janë 18 milion e 883 mijë e 720 euro. Shkalla e inkasimit e këtij buxheti është 98.91% për të gjitha njësitë buxhetore. Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësitë buxhetore: p.sh. kodi 13140, transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit 9352 euro, mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit 5158 euro. Kodi 13430, shërbimet e ndryshme shëndetësore 359 mijë e 955 euro. Çka janë këto shërbime, në vija të trasha një sqarim ku janë dhënë këto para. Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale – këtu po get që është keqpërdorim total i këtij buxheti, 510 mijë e 352 euro. Kjo për mu më befason. Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, kjo është e paqartë për mu dhe besoj edhe për këshilltarë të tjerë. Paisje tjera 161 euro – çka janë këto paisje, cilat paisje? Drutë dhe prodhimi druror për ngrohje 253 mijë e 759 euro. Unë po pyes: sa ka qenë një metër dru? Mirëmbajtja e rrugëve lokale 259 mijë e 312 euro. Çfarë mirëmbajtje bëjnë fare, vetëm me thanë mirëmbajtje? Sidomos mirëmbajtje verore nuk bëjnë fare, e dimrit

heqin borë. Paisje tjera, kodi 13509 – paisje tjera 161 mijë euro. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar–dhjetor 2025. Tek drejtoria për buxhet dhe financa, tatimi në pronë: të planifikuara 566 mijë e 265 euro, të realizuara 675 mijë e 697 euro, apo 119%. Këtu duhet me ditë që të planifikuara kanë qenë për vitin 2025. A janë këto para që janë tubu për vitin 2025 apo janë borgje që kanë mbetë? Sepse nëse janë të mbledhura, është arritje e mirë. Tek regjistrimi i automjeteve: të planifikuara 117 mijë e 271 euro, të realizuara 137 mijë e 705 euro apo 117.43%. Këtu kjo shifër është rritë për shkak se ka pas numër më të madh të kerreve, janë regjistru më tepër automjete. Kamionat kanë një shifër tjetër dhe sigurisht ka pas regjistrime më shumë se vitet tjera. Tek urbanizmi për leje ndërtimi: të planifikuara 90 mijë euro, të realizuara 87 mijë e 888 euro apo 97.65%. Domethënë mirë që janë realizu, po qysh ja keni nis, tokë pjellore nuk keni me lan fare në Viti, vetëm për ndërtesa keni me dhan. Të hyrat nga donacionet janar–dhjetor 2025 janë donacione nga Unioni Evropian, projekti ndërkufitar me komunën e Gostivarit 377 mijë e 321 euro dhe participimi i qytetarëve 78 mijë e 223 euro, domethënë gjithsej 455 mijë e 545 euro. Tek participimi i qytetarëve, qytetarët janë anku më shumë. Kam bisedu me ta për mjetet për bujqësi që i jepni, serrat. Ata paguajnë 20% participim, po ata thonë se janë tu pagu së paku 40%, sepse blerja e tyre bëhet me çmim shumë më të lartë se me ble individual vetë. Tek bujqësia, shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore: në vitin 2024 kanë qenë 4028 euro, kurse në vitin 2025 kanë qenë 10 mijë e 191 euro, domethënë është katërfishu. Domethënë ka qenë vit zgjedhor dhe e kanë bë tokën bujqësore, e kanë shndërru në tokë ndërtimore. Kjo u ka qenë dhuratë, e kanë shfrytëzu momentin që u ka qenë vit zgjedhor. Tek shërbimet publike, shfrytëzimi i hapësirës komunale: në vitin 2024 ka qenë 17 mijë e 718 euro, kurse në vitin 2025 ka qenë 19 mijë e 798 euro. Është mirë, po nuk po e dimë se ku i keni marrë këto pare, ku e kanë shfrytëzu hapësirën publike këta qytetarë. Investimet kapitale për periudhën janar–dhjetor 2025: ndërtimi i kanalizimeve, në një vend 50 mijë euro, në një tjetër 48 mijë e 970 euro, domethënë gjithsej 98 mijë e 970 euro. Ku është bërë ndërtimi i këtyre kanalizimeve? Investimi i sheshit në Viti 180 mijë e 74 euro. Për cilën pjesë të sheshit, se sheshi u ba, nuk po dihet se ku është sheshi e çka është ba, sa tu ditë hiq. Ndërtimi i fushave sportive 310 mijë e 900 euro – ku janë ndërtu këto fusha sportive? Asfaltimi i rrugëve rurale 200 mijë euro, po nuk po dihet se ku janë asfaltu këto rrugë rurale. Ndërtimi i rrugëve me zhavorr – këtu e ka pas krejt një firmë, një njeri që e ka firmën e vet – 577 mijë e 400 euro. Ku është shtru ky zhavorr dhe çfarë zhavorri ka qenë? Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike për periudhën janar–dhjetor 2025: shpenzimet kapitale buxhetore të alokuara kanë qenë 4 milion e 445 mijë e 84 euro, shpenzimet janë 4 milion e 300 mijë e 636 euro apo 96.77%. Po kjo është befasi, për investime kapitale kjo shumë nuk është shfrytëzu as 70%. Nën 70% është shfrytëzu, po nuk duhet me e qit tek investimet kapitale, po duhet me e cek shumë mirë aty ku kanë shku këto pare. Krahasimi i shpenzimeve për vitin 2024 dhe 2025: shpenzime këshilldhënëse për vitin 2024 janë shfrytëzuar 154 mijë e 427 euro, kurse për vitin 2025 janë shpenzu 510 mijë e 352 euro, domethënë trefish më shumë. Prapë ka qenë vit zgjedhor, këto pare kanë shku "shkel e shko", është mendimi im personal. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve: në vitin 2024 kanë qenë 36 mijë e 163 euro, kurse në vitin 2025 kanë qenë 38 mijë e 962 euro. Domethënë mu po më doket shumë afër 40 mijë euro mirëmbajtje të veturave. Kurse pagesat te totali i investimeve kapitale për vitin 2024 kanë qenë 3 milion e 840 mijë e 342 euro, kurse në vitin 2025 kanë qenë 4 milion e 300 mijë e 636 euro. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore: në vitin 2024 kanë qenë 519 mijë e 358 euro, kurse në vitin 2025 kanë qenë 1 milion e 735 mijë euro. Kjo i bjen që investimet kapitale në vitin 2025 kanë qenë 2 milion e 566 mijë euro. Dhe obligimet e papaguara deri në fund të vitit 2025 që i ka komuna jonë janë 4 milion e 576 mijë e 560 euro.

**z.Labinot Bislimi:** Të gjitha këto pasqyra financiare, ashtu siç u theksuan nga kolegët e mëparshëm janë të paqarta edhe për neve, se leje më për publikun. Në faktt këto janë një kopi paste i atyre që ju thojnë regjistra kontabël, po që neve ajo që na intereson është përshkrimi i tyre, ku kanë shku realisht ato mjete, jo vetëm me naj dhënë shifrat kontabel neve, sepse ne nuk e dimë as nuk kemi mundësi me i analizu, Kështu që, normalisht kur të bëhet një raport financir, këtu duhet me qenë edhe i gjithë përshkrimi, dhe duhet që, ai që e banë këtë raport, me i detaju një për një ka kanë shku këto të hyra, dhe ky ekzekutimi i buxhetit, saktësisht, p.sh.: e shohim se, 12 mijë euro kanë shku për telefoni mobile. Për cilat telefona mobil? A janë ble telefonat, a është pagu abonimi për ata telefona? Ne duhet me pas një përshkrim, që me e bë punën tone, që me e analizu buxhetin, se

këto përshkrime të përgjithshme, në fakt krijojnë dyshime tepër të fella për keqpërdorim, që ne nuk mundemi me e verifiku nëse nuk ka pas keqpërdorim. Le të bëhet raporti siç duhet, përndryshe, për mu të gjitha këto pasqyra financiare janë tepër, tepër në dyshim e sipër. Dhe kur ti futemi fellit, ato kanë me dal që kanë pas keqpërdorim. E kam fjalën që mos na qitni punë me shku me e verifiku një për një, po le ta banë raportin siç duhet ai që e banë, që me mujt me e analizu menjëherë, që me ra dakort me juve apo mos me ra.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Edhe unë fillimisht ju uroj besimtarëve muslimanë për muajin e shenjtë të Ramazanit dhe do të bëj përpjekje maksimale, sepse drejtoresha e ka një rast familjar edhe drejtori i bujqësisë mungon sot me lejen tonë. Bëra përpjekje me i marrë të gjitha pyetjet dhe do të ju përgjigjem. U tha pak profesionalizëm e shumë politikë, me plot kuptimin e fjalës. Në radhë të parë duhet t'i kuptojmë se çka paraqesin pasqyrat financiare, çfarë standarde kanë këto pasqyra, a i bën vetëm komuna e Vitisë apo krejt komunat. Është një standard që e bëjmë krejt kështu. Dhe për të gjithë ju të interesuarit më në detaje, mund të kërkoni një raport analitik. Mund të keni qasje në dokumente zyrtare dhe drejtoria do të japë raportin për të gjitha ato që kërkoni. Duhet të largohemi nga fjalori se dyshojmë për keqqeverisje. Mundet me dyshu plot, bile tash hiq nuk ju ka hije, se zgjedhjet i kemi pas para dy-tre muajsh. Qeti kryetarit që i ka udhëheq tre mandate, qytetarët i kanë thanë prap vazhdo. Jakupi e tha që këto pasqyra nuk paraqesin gjendje reale, po një keqregjistrim. Unë nuk i tham kësaj profesionalizëm, se ky standard nuk është pasqyrë financiare që nuk i nënshtrohet auditimit dhe të cilët auditorë nuk e thonë a e ke pas mirë apo të ka munguar qeky standard në nivel të Republikës së Kosovës. Pasi qetu e ki një të thënë të pavërtetë të futur, çdo e dhënë këtu pasqyron komunën e Vitisë, pasqyrohet edhe në ministri. Një nga këshilltarët tha nuk jeni të përgjegjshëm në dhënien e saj. Këto me kohë i keni marrë, u paraqit gjendja reale e saktë. Jakupi thotë: e ki 98% shkallën e realizimit të investimeve kapitale, ndërsa te investimet kapitale i ki 1 milion e 700 mijë të marrura nga përmbaruesi privat. E saktë, këto janë shpenzu nga kodi që kanë qenë për investime kapitale. Pyetja tjetër: a janë të gjitha këto të marrura nga përmbaruesi të kontratës kolektive apo edhe të tjera? Po, ka edhe të tjera, po 90% është nga kontrata kolektive. Unë po përgjigjem në ato që i di, nëse ato që nuk i di përgjigjem në seancën tjetër. U tha që këto pasqyra financiare janë alarmuese, Majlinda tha, dhe tendencë për manipulim dhe për mbijetesë politike. Pasqyrat financiare nuk i bën kryetari i komunës, oj Majlinda, këto i bëjnë zyrtarët. Në zyrën ku punohen pasqyrat financiare, 12 vite i kam nënkryetar, nuk e di a jam kanë një herë edhe kryetari. Jam i bindur se nuk ka hi. Pasqyrat financiare për vitin përfundimtar deri më 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik të vitit 2017. Raportimi financiar sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga ligji për menaxhimin e financave publike, përgjegjësitë plotësuar-ndryshuar me ligjin në fjalë. Jam në gjendje me jau dhanë në rast se nuk i përmban këtu. Nëse dini diçka që në pasqyra financiare ju ka mshef, nuk ju ka dhënë, nuk ju ka pasqyru, ti ki të drejtë në plotni me ngrit zërin. Por me thënë pasqyrat financiare që po mshefet diçka ose manipulim kur nuk ka asnjë çështje të fshehur, nuk qëndron. Një prej çështjeve të cilat i ngritët është hargjimi i 510 mijë eurove për shërbime këshilldhënëse, që po ua lexoj se këtu e keni: Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshje me ASHR Lindi për realizimin e aktivitetit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal – 28 mijë e 227 euro; Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshje me United Nations Development Programme, programi për qëndrueshmëri ekonomike dhe promovimi i zhvillimit të sektorit privat – 40 mijë euro; Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse për përmirësimin e shërbimit në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe administratës – 29 mijë e 800 euro; Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse për hartimin e hartave zonale – 89 mijë e 298 euro; Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, marrëveshje me Kosova Med për shërbime publike dhe mirëqenien e qytetarëve – 312 mijë euro. Dhe krejt kjo është 510 mijë euro. Në rast se doni më të hollësishme, është atje analitika. Shkon në qasje në dokumente zyrtare dhe detajisht, në rast se ende doni me i kuptu. Është një ndërtesë që quhet Universiteti i Prishtinës, fakulteti ekonomik. Shkon studion 4 vite, specializon, e kryen dhe i kupton detajisht.

**z.Artan Musliu, drejtor:** Majlinda, prej 5 shkurtit unë jam drejtor i shërbimeve publike dhe emergjencave. E the një të pavërtet të madhe në raport me këndin e lojrave. Këndi i lojrave është riparu javen e kaluar: janë ndërru disa pajisje, janë ngjyros shumica e pajisjeve aty, gjithashtu janë ndërru dhe ulëset në parkun e qytetit

dhe shportat e mbeturinave. Dua të themë që, tani e tutje përçdo gjë që ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, këtu jam unë, dhe nuk lejoj me fol situatë të cilat nuk janë të vërteta. Për shkak të këtyre fjalëve mundet me u kriju opinion i caktum në raport me qeverisjen komunale në nivel local. Të lutem shumë, ki kujdes me atë që flet në raport me drejtorinë time.

**z.Majlinda Shabani:** Drejtor, po të uroj për pozitën. Po më pëlqen fakti që e ke marrë me kaq shumë seriozitet dhe përgjegjësi detyrën e drejtorit. Ti the që je drejtor prej datës 5 shkurt 2026. Ne jemi tu i komentu pasqyrat financiare për vitin 2025. Ku qëndron e pavërteta këtu? E dyta, me më tregu mua për pavërtetësi në qytetin ku unë jetoj, këtë gjë nuk ta lejoj jo veç ty, po askujt. Thash shumë qartë: je drejtor dhe mu më bëhet qefi që e ke marrë detyrën me kaq shumë seriozitet, po një gjë ta kesh parasysh që nuk ki me pas kaq shumë kompetenca me vendos për drejtorin. Javën e kaluar është riparu. Qe 10 vite as edhe një cent nuk është investu. Qka fola unë? Qe 10 vite asnjë cent nuk është investu në atë kënd të lojërave. Unë fola për shpenzimin që është bërë 100 mijë euro në rregullimin e hapësirave gjelbëruese për vitin 2025. Ku qëndron e pavërteta? Sa ka kushtu ai kënd i lojërave? A don me më shitë këtu pallavra, a çka don me folë? Po don me ndryshu edhe gjuhën këtu, se si me folë. Po rren. Shko thuj kryetarit atje: "Po rren", se ne nuk rrejmë këtu. Nëse dëshiron, mund ta bëj edhe një **version pak më të rregullt për lexim publik (p.sh. për mbledhje ose debat)**, prapë **pa ia ndryshu dialektin**, vetëm me rrjedhë më të qartë.

**z.Artan Musliu, drejtor:** Unë të degjova me vëmendje, ti the që nuk është bërë asnjë investim në këndin e lojrave. Deri tani, nëse nuk i mban mend çka ke fol, më vonë e kqyr ingjizimin. Unë thashë, prej momentit që jam drejtor i shërbimeve publike, nuk lejoj, jo ti, por askush me fol të pavërteta. Ti ki të drejtën tënde me kritiku, çka do që ti mendon, por të paverteta nuk mundesh me thanë.

**z.Majlinda Shabani:** Asgjë që unë foli në seancën e Kuvendit Komunal nuk është e pavërtetë. Kem tu raportu për vitin 2025. 100 mijë euro të shpenzume nuk janë pa kërkund. Të pavërteta unë nuk di me fol, këtë ta kish të qartë.

**z.Basri Aliu:** Tendenca për me paraqitë diçka të pazakonshme në këtë kuvend po qëndron ende, e sidomos nga grupi parlamentar i Vetëvendosjes. Unë më së pari distancohem prej disa fjalëve të cilat u përdorën këtu, si nga ana e këshilltares, por edhe nga ana e drejtorit. Drejtor, prej se e ke marrë mandatin, ti duhesh pak mu përgjigj edhe në pyetjet e viteve të kaluara. Duhesh me qenë i përgatitur për këtë punë. Nuk thuhet ajo "prej kurit e kam marrë unë, tash janë bë investime". Investimet janë prej vitit të kaluar, nuk janë prej tash që ke ardh ti, edhe në këtë rast duhesh me qenë pak më i sinqertë. Thash, tendenca për paraqitje manipulimi ndaj ekzekutivit për vitin 2025 po shihet në këtë kuvend, po sigurisht edhe e dinë se pasqyrat financiare paraqesin një shpenzim i cili është kry. Ka mundësi me pas aty edhe shpenzime të vitit 2024 që projektet janë bartë, sikur që kanë mbetë borgjet për vitin 2026. Prandaj këto shpenzimet nuk e paraqesin realizimin e projekteve, po i paraqesin shpenzimet e mjeteve të cilat i ka pas buxheti komunal. Për me ditë se ku janë shku këto mjete, të drejtën e ka gjithsecili prej neve me shku me lypë faturat, sepse me t'i pru të gjitha faturat ku janë shku shpenzimet e tyre, sigurisht keni me thanë: "Çka është tu u bë me këto?" U përmend edhe mirëmbajtja e rrugëve. U tha që nuk është intervenu fare dhe nuk dimë çka është bërë. Që nuk doni me pa ose me ditë: mirëmbajtja e rrugëve është edhe pastrimi i qytetit prej kompanisë që ka qenë. Ka pas ndërhyrje, sikurse në Lubishtë që u ndërhy në rrugën e dëmtume, gjithashtu edhe në rrugën që ka qenë e ministrisë. Ne kemi ndërhy dhe kemi sanu gropat, sidomos prej Sodovinës deri në Viti, domethënë nuk ka qenë kompetencë e Komunës së Vitisë, por e ministrisë. Ka qenë edhe kërkesë e z. Jakup që me ndërhy në ato dhe ne kemi ndërhy. Nuk ekziston ajo që u tha që nuk u ndërhy në rrugë. Shfrytëzimi i hapësirave publike — u bë një pyetje. Dihet që të hyrat për hapësira publike janë edhe tarracat të cilat shfrytëzohen, por janë edhe një pjesë e qirave të cilat janë dhënë nga ky kuvend.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Dalloni pasqyrat financiare me realizimin e punëve. Për çdo punë që doni me diskutu, e bëni kërkesën, i autorizojmë e bijnë informatën dhe diskutojmë për ato cilat janë realizu çka është kry. Pasqyrat financare, Drejtoria e Financave ka me i pasqyru financat edhe të kuvendit, tonat edhe çdo drejtorie, ka me tregu veç sa u pagu, se nuk dinë me dhanë për projekte, sepse nuk e kanë natyrën e tillë. Natyrën e tillë e kanë ata çka janë kompetent për realizmin e projekteve, dhe duhet ne t'i kërkojmë për punë të caktuara, në seanca të caktuara, për me na pru informatë.

**z.Labinot Bislimi:** Deshta me uru Artonin për pozitën e drejtorit që ka marrë, por gjuha nuk e lejoj. Nuk i takon jo drejtorit, por askujt këtu, sepse edhe më herët kryesuesi tha: "Nuk ki drejt me folë, nuk e ke fjalën." Ndoshta po, por drejtë kemi me folë. Nuk jeni ju që na përcaktoni as gjuhën, as mënyrën, as qasjen. Nuk jeni ju që na e lejoni ose nuk na e lejoni se çka thojmë. Dhe po jua kujtoj një send: ne jemi politikanë vetë. Ky kuvend është politik, është përfaqësues i qytetarit dhe me politikë mirremi. Nuk mirremi këtu me ekspertizë; kur të vjen puna për ekspertizë, mirremi me ekspertizë. Gjuha jonë është politike dhe jemi tu folë për politikat publike në hapësirë publike. Aspektet personale as që më interesojnë të asnjerit këtu, as të miat nuk duhet me ju interesu, por nuk jeni ju që na e përcaktoni gjuhën këtu. A kemi të drejtë apo nuk kemi të drejtë me folë? A kemi të drejtë me shty një anë apo kemi të drejtë me shty tjetrën anë? Për këtë punë jemi këtu, për këtë jemi zgjedhë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Unë thashë që nuk ke të drejtë më fol pa ta dhënë fjalën. Për me fol me rend, për çka flitet, çdo kush e ka qëndrimin e vetë dhe mendimin e vetë, asnjëherë nuk i kam ndërhy kujt çka me fol.

**z.Artan Musliu, drejtor:** Labinot, faleminderit për urimin. Unë nuk thashë që ju duhet me fol qysh unë ju thamë çka me fol, që në mënyrën e operimit të juaj këtu në Kuvend Komunal të Vitisë me fol në mënyrë të përgjegjshme, mos me fol të pavërteta. Për domenin e punëve të shërbimeve publike, për të cilën unë jam përgjegjës tash e tutje, unë thash, nuk lejoj me thanë të paverteta, kjo është çka thashë më heret. Besoj që pajtohesh për këtë, për shkak se ne jemi me pasqyru realitetin që ndodh e jo me kriju gjëra të paqëndrueshme. D.m.th, folem mbi bazën e fakteve dhe argumenteve. Për çdo kritikë, këshill, sugjerim që ju e thuani, e që është në shërbim të përmirësimit të performances së shërbimeve publike dhe të nivelit komunal jeni të mirëpritur dhe mirëseardhur.

**z.Labinot Bislimi:** Duhesh me i kuptu rolet e tona. Ne nuk jemi për me të ndihmu në performancën e drejtorisë tane. Nuk është puna jonë, ajo është puna jotë. Ne jemi këtu për me verifiku performancën tane. Ky është një dallim thelbësor të cilin duhet me e kuptu, edhe fjalorin tonë edhe qasjen tonë. Ne jemi opozitë dhe si opozitë e kemi për detyrë me verifiku dhe me kritiku, se këtu rrafsh i ki një pjesë të asamblistëve që kanë me ta bë gjatë të gjithë mandatit, për mos me thanë ndoshta edhe kanë me mbajt heshtje. Ndonjëherë intervenon sikur Basria, se po më duket se nuk ta ka dhënë bash me qef drejtorin, se po shihet. Po përndryshe, mos prit kritika prej asaj ane.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, urime për postin që ke marrë. U mundove me na frikësu apo me kriju një mburojë me tregu që je dikushi. Ne kemi me ta tregu për 4 vite se kush je dhe puna jote. Këtë mos u mundo me shitë, se nuk të shitet. Edhe për këtë punë, a ke me pas sukses nuk varet prej teje, se ke kryetar tjetër kënd. Po që ti je dikushi e ne pak më ndryshe, atë mos e mendo se nuk bën ashtu. Edhe për çka fole, ty bash nuk të ka taku hiq, se ti tash je drejtor qe 1 javë dhe ti as nuk ki asgjë, as nuk ka pas planifikim prej teje, as realizim. Ti e ke marrë këtë drejtori tash e tutje, por jo çka ka ndodh në të kaluarën. Nënkryetar, te saktësia e dokumenteve po të tregoj që në këtë kuvend ke qenë edhe ti prezent, ku 3 raporte për të njëjtën punë kanë qenë të ndryshme. Ka qenë pasqyrat financiare, raporti i kryetarit edhe raporti i Basri Aliut, drejtori i shërbimeve publike. Më kujtohet kur e kemi zanë: 3 raporte për të njëjtën punë nuk kanë qenë të sakta. Kjo është saktësia e dokumenteve të Komunës së Vitisë. Nënkryetar, ke pasë thanë që nuk bëna nënkryetar se e kam kry, po u bëne tash. Kujt me i besu? Ka dëshmitar këtu që kur ka qenë Bekimi ke thanë: "E kam kry, nënkryetar nuk do të jem." Po e kam problem edhe me ta uru, se po të qes keq, se njeri kur nuk e mban fjalën qysh me i besu më.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Nuk e kam pas plan, se e kam ditë se ju jeni përgatit me marrë pushtet, dhe kam thanë boll jan 3 mandate. Kur e kam parë që ju ende nuk jeni të përgatitur, duhet me vazhdu.

**z.Jakup Demiri:** Ti ke thanë: pavarësisht fitoj kush fitoj, unë nuk do të jem nënkryetar. Te pasqyrat financiare asnjë përgjigje nuk e mora. Nënkryetar, u mundojshe me na tregu se qysh duhet me qenë, por nuk jemi nxënës. Mos ta nin, se nuk të korisim ty me dalë nesër në sokak; kerkush nuk thotë se çfarë kuadra ke qitë. Erdhi edhe Berati këtu, u diskutun edhe disa gjëra tjera, sidomos prej ish-drejtorit, shefit të LDK-së, Basria. Ky Basria këto 3 vite dritat në Smirë kanë qëndru ndez ditë e natë. Ai shpenzim është këtu në pasqyrat financiare. Unë me kan tybe në paça moral me u kapë me dikand, e maj kryt pak si ulë, se për shkak të mos punës së disave qytetari paguan. Në pasqyrat financiare, nënkryetar, asnjë prej projekteve në Smirë që janë realizu në fushat nuk i pashë. Asfaltimet që janë bërë — dhe besoj që në Smirë më së shumti ka pas investime për 1 javë sesa për 4 vite të qeverisjes tuaj. Ka pas ndriçim publik, 4 rrugë janë shtru, ka pas intervenime të ndryshme, ka pas

subvencione pa e pasë emrin hiq njeri. Krejt këto gjëra kanë ndodh. Ka pas kartela nëpër secilën shtëpi të investimeve të drejtorave. Po çka me ba tash, a është e vërtetë? Ja ka çu ndriçimin publik te shpia, ja ka dhanë kartelën, ka ble votë me ta.

**z.Basri Aliu:** Labinot, nuk kam qenë i interesuar për me qenë drejtor, se edhe 1 vit dalë në pension. Kështu e kam pa të arsyeshme që qytetarët ma kanë dhanë votën me nejt këtu, për atë e kam zgjedhë këtë anën tjetër. Ndoshta edhe më ka konvenu, me thanë thjesht me qenë më i sinqertë. Sa i përket ndriçimit, normal që ka pengesa herë pas here, edhe në ndriçim edhe çdo kund. Për atë janë edhe kontrata që intervenohet në këto gjëra. Ne nganjëherë nuk po kemi ndriçim edhe hiq, po na ndalet ka 2-3 ditë dhe nuk po e bajmë kaq të madhe, po flas për rrymë. Në një pjesë tjetër më lavdove, ku the që u investu në ndriçim e në gjëra tjera. Zëvendësministrat e shteteve tjera nuk i kemi pru në Smirë.

**z.Elham Emërllahu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Si pikë e rendit të ditës është shumë e rëndësishme, sepse po flasim për pasqyrat financiare të vitit 2025, një pjesë të cilat i kisha për diskutim. Shumicën prej tyre i thanë kolegët asamblistë nga opozita, dhe unë nuk jam ekonomist, por me sa e kam parë raportin dhe konsultat që i kam pas me miq, kam ardhë në përfundim që Komuna e Vitisë, gjegjësisht zyra e kryetarit, ka nevojë për një ekspert financiar që po më duket nuk e ka. Respekt për zyrtarët që punojnë në Drejtorinë e Financave, por një buxhet që nuk është shumë i vogël, mbi 19 milion euro, destinimi i tij nuk sjell zhvillim. Bile unë kam parë buxhetet e viteve të kaluara, pothuajse nuk ka ndryshim hiq. Veç për 2026 nuk mujta me gjetë, nuk e di pse. Edhe vitet e kalume është i njëjti trend i shpërndarjes së buxhetit. Edhe nënkryetar, mos kofsha në lëkurën tende, sepse me gjithë respektin për ju si jurist, po interpretimi i kodeve buxhetore dhe formulimi i kodeve të ndryshme financiare mendoj që është dashtë me qenë këtu edhe drejtoresha apo zyrtari përkatës. Po në përgjegjësi, të gjitha pyetjet e kolegëve të mi të opozitës këtu janë pyetje me vend, konkrete për mua, të cilat edhe unë i kam, e që përgjigje nuk u morën. Unë po e kuptoj që nganjëherë po devijojnë debatet këtu, por megjithatë nënkryetar dhe kabineti qeverisës duhet me dhanë sqarime, sepse po bëhen pyetje, po ngriten çështje problem që krejt neve po na shqetësojnë. Nuk janë shifra të vogla. Ndoshta unë kisha pas vërejtje pak me analizu edhe me kriju kursim, sepse nuk shpenzohen mbi 12 mijë euro për telefona mobilë dhe ato shifra tjera që janë 510 mijë për ekspertiza profesionale etj. Prandaj edhe unë e shpreh shqetësimin tim, sikur kolegët e mi. Kisha kërku ndonjë përgjigje pak më profesionale, pak më të qartë. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike pajtohem që është njëra prej drejtorive të rëndësishme. Unë e përgëzoj drejtorin e ri, i uroj suksese. E paska marrë kogja me entuziazëm. Edhe unë i kam vërejtjet e mia. Nuk e di ato kontrata që janë për mirëmbajtje të rrugëve e ndriçimit a kanë skadu apo janë aktive, sepse as në Verban ndriçimi publik nuk është tu funksionu qe më së paku 6 muaj. Kam marrë informata që ka skadu kontrata e mirëmbajtjes, por kur ka skadu ajo kontratë?

**z.Ilir Zuka:** Deshta me u ndërlidh edhe te asamblisti që nuk është tu mujtë me nxan vend, veç e lëshon një fjalë dhe del. Kur ta etiketosh dikend që je kukull e pushtetit, duhesh me ndejt me marrë përgjigje, se për 4 vite unë jam një ndër ata asamblistët që më së shumti kemi ngritë kërkesa e çështje në dobi të qytetarëve. Po është shumë e pahijshme po qysh ka ardh edhe është tu shku. E kanë vlerësu qytetarët, ja kanë dhanë nja 400 vota krejt, përpjekjes së tij. Artan, urime drejtorinë e Shërbimeve Publike. Unë e kam pas një kontakt dhe një punë të jashtëzakonshme me drejtorin e Shërbimeve Publike, që tani e kam shef grupi. Nuk është mirë që e the që prej datës 5 e kam përgjegjësinë. Duhesh me i marrë përgjegjësitë edhe më herët që i kanë lanë, se ne e dimë: ti e ke bë me 6-7 që e ke qitë foton, po e ke marrë prej kontratës që ka qenë më herët. Domethënë ka edhe shumë gjëra tjera që është mirë me intervenu. Ti e din që në cilësinë e administratorit të fshatit Pozheran kam dorëzu një kërkesë te ti për ndriçimin publik, që rruga kryesore ka qe 3 muaj që nuk bën. Po tu i ditë ne problemet, tu e ditë kontratën kolektive, asnjëherë nuk ju kemi ngushtu që patjetër me i bë. Po tash me ja lanë fajin këtij drejtorit, kjo nuk është e hijshme. Gjithashtu, Zyrafete, urime për postin e drejtoreshës. Suksese.

**z.Artan Musliu, drejtor:** Ilir, jo për me i ikë përgjegjësisë, po unë nuk muj me marrë përgjegjësi për diçka që ka ndodh në 4 vite të kaluara. Domethënë është parim edhe politik edhe juridik. Unë marr përgjegjësi prej momentit që jam përgjegjës për një punë të caktume që ma ka besu, në këtë rast, kryetari i komunës. Jo për me i ikë përgjegjësisë, po për diçka që nuk e din, më mirë është mos me u përzi sesa me u përzi. Edhe e dyta, te kontrata e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, unë pardje e kam iniciu shpalljen e tenderit për ndriçim publik. Në

momentin që e kemi të gatshme nënshkrimin e kontratës, të gjitha këto adresime që ju po i cekni kemi me i adresu dhe rregullu.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** E kuptoj këshilltarin që ngre disa çështje, por e kuptoj që edhe është për herë të parë këshilltar komunal dhe nuk është në thelb të problemit. Se thotë kryetarit i vyn një economist; kryetari e ka ekonomistin, e ka sektorin, njerëz profesionalë shumë eminent në drejtori. Por megjithatë është dashtë me i përcjell edhe trendet të cilat i ki të pasqyruara te pasqyrat financiare, ku një prej tyre katalizatori kryesor ka qenë kontrata kolektive që ia ka prish edhe Kuvendit Komunal aprovimin e buxhetit, që i ka ndërhy. E thua mos kofsha në lëkurën tende, por secila lëkurë e ban organizimin e vet. Ti nuk mundesh me bajtë këtë temën se ndoshta është e rëndë, por megjithatë ky organizmi im e banë. Ajo që mua më bën përshtypje, kur je me të vërtetë – sjelleni që ju e keni dhanë një betim. Mos harro, në kuadër të betimit i ke 19 fusha të cilat janë kompetencat e juaja dhe të komunës. Edhe te unë, kur nuk kam dashtë me qenë profesor dhe mësues, por nuk ka më keq për një këshilltar komunal që i përfundon 3 mandate dhe ende nuk fokusohet në ligjin e Republikës së Kosovës që ia ka caktu mandatin dhe ende nuk fokusohet në betimin e vet të cilin e ka dhanë. Dhe nuk ka më pak përgjegjësi për një këshilltar të Kuvendit Komunal kur vetëm një seancë kryetari i komunës – kryetari sa ka marrë mandatin ka dhanë betimin – dhe ti i flet: po ai po kqyr. Ti a je në luftë me 9 mijë banorë që ia kanë dhanë votën apo je në luftë me një individ? Nuk bisedohet më ajo çështje. Unë konsideroj që tash bisedohet për pika të rendit të ditës. Dhe thu që nuk more përgjigje konkrete. Qe përgjigje konkrete: unë mora fjalën me të përmirësu se the aty, po përmendën 510 milion – janë 510 mijë, se del keq. The buxhet shumë i madh 19 milion. 9 milion e tepër i ki paga dhe mëditje që nuk i sheh, dhe po bisedohet për 8.8 milion që aty janë veç duhet ta kemi parasysh: investime kapitale, shërbime, mallra, shpenzime komunale, subvencione. Këto çështje gjithherë dihet që te çështja e buxhetit kemi me pasë raste me debate, edhe tash për 2027. Dhe këto kontura janë të rregulluara në aspekt ligjor. Ti çon ministria në kuadër të saj, se po thu që i keni kuptu. E ki çështjen e manipulimit se sa – se ti nuk mundesh me ndryshu qysh mendon, se komunës i ndahet buxheti në bazë të banorëve, territorit, vizitave në ambulantë dhe numrit të nxënësve të cilët i ka. Kush ka mundësi, sikur këta të rendit të dytë, se kanë mundësi se kanë qeverinë në plotni të veten me na sjellë projekte prej ministrisë, mos me na lanë dikënd me shku për kokë banori 207 euro, diku 4 euro, po me thanë që edhe Vitia është pjesë e Kosovës. Nuk ka lidhje pse udhëheq LDK, se pas zgjedhjeve nuk përmendet më cili subjekt politik, po duhet përmendet kryeministër, kryetar, se ka marrë besimin e qytetarëve dhe në këtë formë duhet të hecim. Kush e don vendin e vet dhe kush e don Vitinë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Kjo është informatë dhe nuk del në votim, shkojmë me një pauzë, vazhdojm në ora 1.

Pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026**

**z. Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Matrialin e keni marr me kohë, është një tabelë e orientimit të datave të mbledhjeve, nuk do të thotë që do të përmbahet kjo tabel 100%. Planin e punës së Kuvendit e kemi miratu: nëse ka për diskutim, fjala është për ju?

**z.Jakup Demiri:** Kryesues, si me kalu në pikën e tretë të rendit të ditës, kur pika e dytë nuk u mbyllë? Nuk morra përgjigje unë për asnjë pyetje që parashtrova.

**z.Elham Emërllahu:** Kryesues, edhe unë pajtohem me Jakupin, që mendova, që nuk u mbyll pika e dytë e rendit të ditës.

**znj.Majlinda Shabani**: Edhe unë mendoj që ende nuk është mbyll pika e dytë e rendit të ditës, dhe nuk na u dhanë përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga ana e këshilltarëve.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Të gjitha përgjigjet që nuk ju kanë dhënë, kërkoj që në seancën e radhës të ju jepen. Pasi që nuk ka për diskutim për pikën e tretë të rendit të ditës, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Para jush e keni materialin për formimin e KKSB-së, të cilin e përcakton Udhëzimi administrativ 27-2012, dhe secili anëtar i KKSB-së shkon në bazë pozitës që e ka, prandaj sot edhe e kemi kompletu emrat e anëtarëve të KKSB-së, dhe kërkoj që të miratohet ky propozim vendim.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Hapi diskutimin nëse ka për diskutim.

**z.Basri Aliu:** Ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim: kush është që të miratohet ky propozim vendim? Me votat e të gjithëve miratohet edhe ky propozim vendim.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët do të përfaqësojnë Komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës**

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** E kemi pranu një shkresë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, që me i caktu përfaqësuesit, ku kryetari i Komunës shkon direkt, ndërsa nga partitë tjera nga një anëtar. D.m.th, tri parti më të mëdhaja do të kenë përfaqësues.

**z.Ilir Zuka**: Nga radhët e LDK-së propozoj, Basri Aliun.

**znj.Elsa Jahija**: Përshëndetje për të gjithë. Nga radha e PDK-së e propozojmë, Nuhi Ramadanin.

**znj.Majlinda Shabani**: Nga LVV-ja propozojmë, Jakup Demirin.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk kemi të tjerë propozime: a jeni që të miratohen këto propozime? Me votat e të gjithëve u miratu edhe ky propozim vendim.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete projekt i realizuar ne vitin 2025 dhe 20% e participimit të fermerve përfitues ne mekanizem bujqesor dhe serra nga subvencionet per vitin 2026**

**z.Avni Misini, zyrtar nga Drejtoria për Bujqësi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm.
Në mungesë të drejtorit, me qenë se sot nuk është prezent, ky propozim-vendim ka të bëjë me drejtorinë e bujqësisë. Para jush po e prezantoj këtë propozim-vendim, i cili ka të bëjë me alokimin e buxhetit lidhur me participimin e fermerëve për fletë dylli dhe koshere. Ky projekt është i vitit 2025, mirëpo për shkaqe të ndryshme nuk kemi mujt vitin e kaluar me e miratu në kuvend. Kodet janë të përcaktuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Përqindja prej 20% është e përcaktume për participim të fermerëve që janë përfitues, dhe është e përcaktume në bazë të rregullores për ndarje të subvencioneve të komunës. Domethënë, me qenë se e kemi bë edhe për vitin e kalum, edhe për këtë vit parashihet që kodet 92500 dhe 92503, që paraqiten për mekanizëm bujqësor dhe serra, kërkoj që të aprovohet ky propozim-vendim, por me disa ndryshime. Është një gabim teknik: te sasia e kosherëve e kemi 25, ndërsa në realitet duhet me qenë 120 copa. Edhe te pjesa e totalit të projektit ka qenë 4800 euro, ku pjesa e participimit që u takon fermerëve është 960 euro. Pra, kemi një gabim teknik që kërkoj në vendim të përmirësohet.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Hapi debat.

**znj.Majlinda Shabani:** Po thuhet për aprovimin e buxhetit me participim. Jemi tu fol për vitin 2025. Me sa po e kuptoj unë, projekti është realizu, po në fakt mjete financiare nuk është që kanë qenë, edhe tash po dojmë me ba alokimin e mjeteve për vitin 2025, madje edhe për vitin 2026. A është realizu projekt për vitin 2025?

**z.Avni Misini, zyrtar nga Drejtoria për Bujqësi:** Projekti është realizu, pjesa e participimit është kry, mirëpo pa miratim të kodeve nuk shkon në Ministri të Financave.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Për mos me ardh dy here propozimi, ky propozim është edhe për vitin 2026, se për vitin 2025 e kemi kalu.

**z.Basri Aliu**: Ne si grup i LDK-së e përkrahim këtë pikë, pasi që është në të mirën e operatorve ekonomik, që sa më shpejt të ju dalin mjetet në llogarinë e tyre.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim, me ndryshime që u ceken. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m$^2$, në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja, do të jetë parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m$^2$**

**zn.Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm, para juve e paraqes propozim vendimin për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m$^2$, në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jet parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m$^2$. Ky propozim bazohet në nevojën reale për rritjen e kapaciteteve të edukimit të hershëm në Komunën tonë, dhe është në përputhje me bazën ligjore përkatëse. Jemi në fazën e përgatitjes së dokumentacioneve për paraqitjen e kërkesës edhe në Ministri të Arsimit, Shkencës, me qëllim të mbështetjes së realizimit të këtij projekti. Ju ftoj që ta miratoni këtë propozim vendim.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Më konkretisht, në oborrin e shkollës në Sllatinë të Epërme, të ndahet një pjesë për ndërtimin e çerdhes në atë pjesë. Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Dhe si pikë të fundit të rendit të ditës, kemi pyetje dhe përgjigje. Hapi diskutim nëse keni pyetje.

**znj.Elsa Jahija:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Duke marrë parasysh ankesat e shumta të qytetarëve, lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm në Komunën e Vitisë, kërkoj nga nëkryetari i komunës një informim të detajuar mbi gjendjen aktuale të furnizimit me ujë, duke pas parasysh mungesat e theksuara në disa zona. Gjithashtu kërkoj sqarim lidhur me cilësinë e ujit në fshatrat ku furnizimi ekziston, por sipas analizave të fundit laboratorike, në kohën e reshjeve të shumta, cilësia rezulton shqetësuse. Pyetja është, se cilat masa konkrete janë ndërmarr? A po planifikohen për përmirësimin e furnizimit dhe garantimin e ujit për konsum?

**z.Labinot Bislimi:** Mu dok që çështja më e rëndësishme e ditës ishte kjo puna e parcelës së çerdhes. Unë jam plotësisht kundër ndërtimit të çerdheve të reja, sepse sektori publik në komunën e Vitisë është ka zgjerohet e zgjerohet me shumë objekte. Dhe gjersa po zgjerohet sektori publik, si me shpenzime ashtu edhe me objekte dhe ndërtime të reja, në të njëjtën kohë po kemi gjithnjë e më pak njerëz. Për me e thanë ndryshe: në një vend ku ka zhvillim kapitalist normal, sektori publik shkon tu reduktu krahas dhe tu performu si që duhet krahas sektorit privat. Sot në komunën e Vitisë ka objekte pa fund të cilat janë krejtësisht të panevojshme, e në shumicën e rasteve të zbrazëta. Nuk e kuptoj fare logjikën e ndërtimit të objekteve të reja, gjersa nuk shfrytëzohen në mjaftueshmëri objektet ekzistuese. Shumica e shkollave janë pa nxënës dhe këtë e dimë secili. Shumica e objekteve të administratës realisht nuk janë të mbushura, ose janë të stërmbushura me klientelizëm, po jo edhe me performancë. QMF-të janë plotësisht të panevojshme, përveç asaj në Pozharan, këtë e dimë secili nga ne. Nuk e kuptoj qysh një kuvend komunal, dhe krejt ne që jemi këtu, votojmë për objekte të reja. Çdo objekt i ri është shpenzim i ri, gjersa ne faktikisht nuk i kemi mbushë akoma objektet që janë ekzistuese. A e dini që ka më shumë institucione komuna e Vitisë sesa krejt Lioni bashkë, që i ka 2 milion banorë? Po kjo ka qenë pika kryesore e rendit të ditës. A ka dikush që e analizon këtë? A i ka kqyr statistikat? Merrni kqyrni statistikat: e kemi sot një mësimdhënëse për 6 nxënës. A janë mbushura ato objekte? Nuk është e vërtetë. Unë vet i kam verifiku. Edhe QMF-të asnjë nevojë nuk e kanë, asnjë funksion – janë shpenzim. Dhe ne sot prap kemi votu për shpenzim shtesë, për objekt të ri.

**z.Ilir Zuka:** Na kemi pas ankesa gjatë zgjedhjeve, që i kemi stërmbush çerdhet me fëmijë. Kandidati për kryetar nga AAK, Dega në Viti, edhe ka shku ka qit foto si po flenë fëmija një mbi një. E keni në fejzbuk të tij. E tash me thanë nuk po na duhen çerdhet, larg mensh.

**z.Labinot Bislimi:** Ilir, ti as nuk e kuptove fjalimin tim. Unë nuk jam kundër çerdheve, as nuk kam thanë që nuk ka nevojë për çerdhe. I ki me qindra statuse të mijat ku ti është mirë me i lexu, edhe me i lexu qysh duhet, edhe me e kuptu. Unë kam kërku që çerdhe me u bë QMF-të, edhe këtë jam tu e kërku edhe tash: që objektet ekzistuese me u shfrytëzu për çerdhe. Nuk e kam kërku një çerdhe shtesë, po kam thanë që, si kandidat për kryetar të komunës, kam me i bë 12 deri në 20 çerdhe tjera. Dhe unë nuk jam tu thanë që nuk ka nevojë komuna e Vitisë për çerdhe, sepse e thash edhe në program: tek janë objektet ekzistuese të cilat nuk janë tu u shfrytëzu ashtu siç duhet. Sepse QMF-të, unë e ti e dimë, e din edhe drejtoresha Kadolli, asnjë funksion të vetmin nuk e kanë. Ato nuk funksionojnë – janë vetëm për klientelë politike.

**z.Ilir Zuka:** Dua t'i thamë me shku me e vizitu QMF-në në Pozharan me pa si funksionon. Sa qashtu qysh po thotë ky.

**z.Labinot Bislimi:** A me dëgjove që thash, përveç QMF-së në Pozharan.

**z.Ilir Zuka:** Ne e kemi shndërru shkollën e Çifllakit në çerdhe. Të jeni të bindur se është bë mirë për atë pjesë. Po gabimi më i madh është bë që, nuk është ndërtu e re. Na e dimi sa problemin e ka pas me vllag e me probleme të njëpasnjëshme.

**z.Labinot Bislimi:** Nuk ki pas nevojë me shku me ba shkollën e vjetër në Çifllak çerdhe. I ke objektet e reja, e ke në Sllatinë, e ke në Smirë, në Sadovinë.

**z.Ilir Zuka:** Po flas për pjesën e Pozharanit. Ne nuk kemi pas një hapësirë tjetër që kemi mujt me e shfrytëzu për çerdhe.

**z.Basri Aliu:** Shfrytëzimi i hapësirave publike – edhe unë pajtohem që aty ku janë të lira me i shfrytëzu, aty ku ka mundësi. Por kur është puna te çerdhet dhe diskutimi rreth QMF-ve që janë nëpër fshatra, ato nuk i plotësojnë kushtet për me qenë çerdhe, sepse ato kanë një hapësirë, dy-tri dhoma. Kështu që ato janë objekte shumë të vogla. Se ne e dimë që ambulanta që ka qenë në Sllatin më herët e kemi bartë tek zyrat e ofiqarisë që kanë qenë aty. Ajo i ka tri hapësira, që nuk ka mundësi të shfrytëzohen për çerdhe, sepse numri i fëmijëve duhet me pas hapësirë dhe komoditet, dhe jo t'i dërgojmë fëmijët vetëm sa ta shfrytëzojmë një hapësirë publike e cila nuk është e dedikume për çerdhe.

**z.Labinot Bislimi:** Ne e kemi një problem të reprezentimit të asaj që i thojmë çerdhe apo që i thojmë shkollë. Gjithmonë e parafytyrojmë sikur aty do të jenë objekte shumë të veçanta apo të dedikume, të bëme special për atë punë. Po është e vërtetë që ka objekte që bëhen në mënyrë të veçantë dhe të specializuara, por çerdhe mundesh me ba edhe këtë kafen që është qetu, në fund të fundit, se është fjala për 10–12 fëmijë, që ti nuk e ke nevojën me i grumbullu vetëm në një pikë. Ka njëqind forma të ndryshme të cilat mujna me i shqyrtu, edhe për çështjen e ushqimit apo të shujtave. A janë analizu të gjitha opcionet, të gjitha alternativat, të gjitha format për këtë çështje? Jo. Ne e votum sot blanko dhe kërkush nuk ofroj asnjë alternativë tjetër, as nuk u ofru asnjë projekt tjetër alternativ. Dhe kjo është fatkeqësia e kësaj qeverisjeje: e ka vendos dikush, e ofron vetëm një opsion dhe duhet me e votu blanko, kurrë pa e mendu që ka alternativa tjera të cilat kanë më pak shpenzime, kanë më shumë përfitim për prindërit, për nënat dhe baballarët, për fëmijët dhe për çështjen e mobilitetit që janë më të mira. Po më duket që është kriju një modalitet me kriju objekte të reja dhe aty dikush përfiton. E sigurt është që dikush përfiton, por e sigurt është që zhvillimi i kësaj komune nuk përfiton – as fëmija, as nëna, as babai. Se në këtë rast shkon njeri voton në Qifllak çerdhe, tu i pas hapësira tjera më afër fshatrave dhe më afër prindërve. Kjo është e tmerrshme, sikur në Budrik që e keni bë zonën industriale, e me folni për eksperta.

**z.Ilir Zuka:** Labinot, unë e di që ato ndahen në AMF, QKMF dhe QMF, kështu që, në qato fshatra që po i kërkon ti, AMF-të je kan i ki vizitu, dhe ti po thu me i mbyll AMF-të, me qel çerdhe. Të jemi të kjart, kandidati i AAK-së që ka qenë për kryetar të komunës, kërkon me u mbyll AMF-të napër fshatra, edhe mu hap çerdhe. Ky është rast me u diskutu.

**z.Labinot Bislimi:** O Ilir, unë e kam pas në program, nuk e kam pas të msheft. Nuk ke nevojë ti me e përsërit ata që e thash, se kjo shënohet në procesverbal. AMF-të e kam thanë në RTK, KTV, për gjatë fushate e kam përsëritë, e kam shkru, edhe po ta thamë prapë, unë jam për me i mbyll AMF-të, dhe QMF-ja e Pozharanit është funksionale, është e nevojshme per ate pjes që e përfshinë. AMF-të në Viti nuk kanë asnjë funksion, ato janë

shpenzim në kuptimin që janë kriju për klientel, dhe administrata komunale, qeverisja e ka për detyrë me tkurrë institucione, apo me shndërru kur është nevoja, sepse ne ju përgjigjemi nevojes dhe kërkesës së qytetarëve.

**znj.Majlinda Shabani:** Nënkryetar, po du me ju pyet për rrugën rreth lumit Morava, e cila është e shtrume me kubza. E kemi diskutu prej fillimi kur është nis ajo rrugë me u punu në atë mënyrë, dhe tani, si që është gjendja momentale, unë po du me pyet se çka ka me ndodhë me atë rrugë dhe a ka naj zgjidhje, muj me qujt emergjente, për qat rrugë që e kemi. Tjetra, te Udhëkryqi që është rruga në Pozharan: qajo rrugë që është e shtrume me asfalt, fillimi aty ku frekuentohet asfalti është komplet, disa pjesë janë me gropa. Po du me e ngrit si shqetësim me u rregullu qajo rrugë. Edhe pyetja tjetër: i kam pa do punime që janë tu u bë në rrugën Viti – Ramnisht, në kanalizime, në trotuar. Dua informacion se çfarë punë janë duke u bërë në atë rrugë dhe pse, sepse e dimë që kohëve të fundit, kur kemi pasë ndeshje të mëdha të shiut, sa shumë ka hasë në problematik ajo rrugë. Dhe dua ta di çfarë masa ka ndërmarr komuna, se po shoh që ka javë që është duke u punu në atë rrugë.

**z.Ekrem Abazi:** Kam një kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike. Te rruga Kemajl Azizi, para disa viteve një përrua ka fillu me u shtru, pjesa me gurë që shtrohet, por pas një kohe shumë të shkurt e kanë lanë në gjysë atë punë. Qe 1 vit, çdo herë që bjen pak shi, lagjen ku unë jetoj dhe një lagje tjetër na merr uji. Edhe te lagjja te betonierka aty duhet me i bë disa veprime sa më shpejt. Ne jemi në hall dhe qytetarët që kalojnë janë në hall. Për ndriçim publik e pash që kishe bë kërkesën, por kisha kërku edhe te lagjja e Halabakeve në Pozheran, te përroska. Rastësisht kam qenë aty pari dhe ajo ish tmerr. Nuk e di ata qytetarë si munden me e bajtë atë përrockë aty. Ish me lloj-lloj mbeturina e mbushur. U befasova, sepse po ja prishke edhe jeshin lagjes.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Nëse do të ishte mundësia te kjo pjesa e rrugës kryesore deri në Kllokot, te ambullanta është një gropë në mes, dhe pa mbërri te rruga e Mogillës janë bërë disa gropa që po i shofë njerëzit, po ju kupin gumat. E di që është rrugë magjistrale, por një ndërhyrje aty është e nevojshme.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Për pyetjet që keni bërë janë shumë me vend. Sa i përket furnizimit me ujë dhe sa është i kontrollueshëm: ato pak lokalitete të cilat janë, në momentin që ne nënshkruajmë kontratë apo marrëveshje me Hidromoravën, dmth i merr në menaxhim tërësisht. Ata kanë një kontratë me Entin Higjenik, nuk e di në sa ditë, por është obligative me bë kontrollen e ujit dhe ka për obligim me lajmru Hidromoravën në rast se uji është apo nuk është i pijshëm. Unë e di se shumë herë kemi pasë rast me bisedu me drejtoreshën Naimi. Thojke që ndodh që del uji i kuq. Pat thanë që mundet me ndodh me dal i kuq, por kur thot Enti Higjenik që është i pijshëm, nuk mundet me pas infektim nga uji. Dmth është ujë i kontrollueshëm gjithherë, po flas sipas fjalëve që kam marrë në aspekt zyrtar. Është e vërtetë që ka një problem kur bjen shi. Momentalisht fabrika në Letnic turbullohet dhe ndalin ujin. Është një lajm i mirë që kemi arritë me fitu një projekt i cili veç i ka qitë shenjat e para dhe do të fillon zgjerimi i kapaciteteve të përpunimit të ujit të pijes, që është në vlerë 6.5 milion euro. Një kontribut të madh ka dhanë edhe Kuvendi, se kanë qenë disa procedura këtu, por ai që nuk është ndalë kurrë në këtë drejtim qe 2–3 vite jam unë dhe konsideroj që është një përfitim bukur i madh. Labinoti po kesh, ka me kesh hala shumë, por nuk është problem. 14 milion jemi kanë krejt komunat, tu fillu prej Gjilanit, Vitisë, Kamenicës, Novobërdës, Parteshit, konkurrent, dhe në konkurrim e sipër ne kemi arritë me fitu një shumë prej 6.5 milion. Vitia nuk participon me pare, por është projekt nga Banka Botërore, projekt i cili do të realizohet në vitin 2026 dhe vitin 2027. Përfundimi i saj, sipas informacioneve që mi kanë sjellë, kjo është gjendja. Labinoti ngrit çështjen e çerdheve të reja dhe m'thot një mendim kundër, që është një mendim demokratik, por nuk ka nevojë me këmbëngulje me thanë çka jeni tu bë. Se në demokraci u lind e u rritë në Francë dhe e din se shumica: ti e shfaq mendimin tanë, e ke shfaqe dhe e ke pas edhe në program për kryetar. Nuk ju ka pëlqy qytetarëve të komunës së Vitisë dhe tash shumica kanë votu për me shku ndryshe. Nuk kemi nevojë gjysmë ore me u sillë rreth asaj me na tregu qysh unë jam, se njëri ka tjetër mentalitet e ne kemi tjetër. Ti e din se edhe ligjet duhet të vijnë në përputhje me mentalitetin dhe zhvillimin ekonomik të atij vendi, se përndryshe nuk mundesh me i implementu. Apo me u kthy te ajo çka e kemi bë në Budrik: është zonë ekonomike, e kemi ndërtu, kemi me jetësu. Vjen ndonjë gjeneratë tjetër e mendon ndryshe. Demokracia shkon në këtë formë. Majlinda në plotni po pyet për këtë rrugën që edhe unë kam thanë sikur ti, se pasi një projekt ka dështu – është ai në mesin e tyre. Kush ka kërku me kubza jam unë, dilemë nuk ka. Kam tregu shumë herë. Tash e tutje i kemi bë menaxherit të projektit presion, na ka dhanë fjalën se së shpejti do të përpunohet ajo

çështje dhe do të rregullohet. Kur nuk e di, por nuk e kemi qitë në harresë. Rruga e Pozheranit duhet me u intervenu. Kjo kontrata që është për mirëmbajtjen e rrugëve nuk është veç për mirëmbajtjen e rrugëve verore, por edhe dimërore. Në Ramnisht është tu punu KEDS-i. Kryetari i komunës e ka ftu një ditë, për shkak se mendum mos po mundemi me tejkalu atë problemin që e kemi të ujit, për shkak se aty kanë qenë gypat, por janë zanë për shkak të betonierkës. Na kanë dhanë fjalën, po dmth KEDS-i është duke i bë telat për tokë të rrymës. Ekrem, e kam pa edhe unë shumë herë, se kaloj shumë herë asaj rruge, por këtë vit kam pa ujë ka të shkojsh. Unë besoj që duhet me qenë program dhe me vazhdu me i eliminu të gjitha vërshimet të cilat i prekin qytetarët. Kryesues, besoj se këto gropa të cilat i the unë do t'ia përcjelli edhe drejtorit të Zhvillimit Ekonomik, ani pse nuk është në kompetencë tonë, por më së shumti e frekuentojnë qytetarët e komunës së Vitisë dhe është mirë me dalë me i eliminu deri sa të intervenon qendra.

**z.Artan Musliu, drejtor:** Për rrugën e Ramnishtes u përgjigj nënkryetari, nuk kam çka me shtu. Është në fazën e vlerësimit cili është opsioni më i mirë për me bë zgjidhje të qëndrueshme, për shkak se nuk po mjafton, kushtimisht me thanë, vetëm harrnimi. Lidhur me pyetjen tënde, Ekrem, është shumë e vërtetë. Unë çdo ditë pres në zyrë kërkesa të ngjashme, ashtu qysh i prezentove ti. Faleminderit për prezantimin. Unë e marrë me shumë seriozitet këtë çështje. Zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike vazhdimisht janë në terren, mirëpo kërkesat janë shumë të mëdha dhe nuk mundemi me i mrri njëkohësisht krejt. Besoj që brenda një kohe optimale kemi me i rregullu. Lidhur me ndriçimin publik, e thashë: në momentin që kemi kontratat aktive, ndriçimi aty ku nuk është tu funksionu ka mu rregullu. Ku kemi mundësi teknike dhe financiare kemi me i shtu kapacitetet e ndriçimit publik. Edhe atë që përmendi Jakupi për defektin që është në Smirë, e rregullojmë. Lidhur me gropat, është shumë e vërtetë: në hyrje të Pozheranit është prish asfalti. Për aty ku tha kryesuesi nuk e di saktë ku e tha, por është edhe në Gërmov një gropë shumë e madhe që është kompetencë e qeverisë. Mirëpo ne, për shkak të vullnetit të mirë, i shërbejmë qytetarëve dhe në kohën më të mirë optimale kemi me i rregullu.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Për drejtorat, ne ta dinë që, pyetjet dhe kërkesat që i bëjnë këshilltarët komunal, edhe me ligj është njëjtë sikur me bë me shkrim, dhe kanë obligim me ju kthy përgjigje.

**z.Labinot Bislimi:** Unë qesha nënkryetar, se çështja e ujit, po bëhet 13-14 vite që po thuhen të njëjtat gjëra, dhe mirë që po merresh qe 3 vite me këtë punë, dhe uroj që një ditë kemi me dalë me sukses, por pas 13 viteve me i ndëgju të njëjtat fjalë përnime është qesharake, për sa i përket demokracisë në Francë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Projektin për Letnicë nuk e ke dëgju që 13 vite, por po e nin tani.

**z.Labinot Bislimi:** Çështjen e ujit jemi tu e ni qe 13 vite. Te demokracia, kur ma përmende, unë nuk jam tu folë për mentalitetin e këtuhit, se e njof mentalitetin e këtij populli dhe zhvillimin e këtij populli. Bile mundemi me folë shumë gjatë për këtë punë, ndoshta edhe me ligjëru në këtë drejtim, për sa i përket zhvillimit: ku jemi, qysh jemi, pse jemi. Unë jam ka flas për mentalitetin qeverisës. Nuk është problemi te mentaliteti i popullit, por te mentaliteti qeverisës, sepse të gjitha vendimet në një demokraci, siç e përmende Francën, merren paraprakisht pasi bëhet një studim për to. Kurse tek ju, në këtë rast, sikur për punën e rrjetëzimit të ujit, nuk ka pas asnjë studim. Ku kanë shku 800 mijë euro këshilldhënie që i lexove më herët? Kur janë bërë, si janë bërë, etj. Si ka mundësi me u marrë vendime të tilla, sikur për me shtri rrjetin pa e siguru burimin e ujit? Si është e mundur? Meqenëse jemi në demokraci, unë po jap vetëm mendimin tem demokratik që qytetarët me kuptu problemin, dhe jo vetëm si e jepni ju. Duhet me pas alternativë të mendimit qytetarët, dhe prandaj quhet demokraci. Si alternativë e mendimit: qysh, dmth, ju i keni marrë vendimet për çështjen e zonës industriale në Budrik? Me cilët ekspertë? Cili ekspert normal thotë që duhet me bë aty zonë industriale dhe qe e keni marrë vendimin me e bë? Qysh mundet me u funksionalizu ajo zonë industriale? Qysh po jau merr mendja, pasi ne të gjithë jemi këtu dëshmitarë të vërshimeve, vetëm të fundit, në atë zonë industriale? Qysh ju po doni tani, tu thirrë në emër të demokracisë, mentalitetit – kishe mendja të popullit – me marrë vendime komplet ilogjike, absurde dhe jo funksionale, dhe ne me ju rreh shuplakë këtu e me thanë "mirë ja keni bë", se qashtu është se keni qeverisjen? Jo, jo, zotri nënkryetar. E kam fjalën që prej se jam këtu dhe para se me qenë këtu unë, gjithmonë e kam dhënë mendimin e duhur. Deri sot, së paku deri sot, nuk jam thirrë në ekspertizë në çështje më absurde dhe jo logjike, që asnjë ekspert normal nuk mundet me t'i udhëzu. Prandaj, të gjitha këto shpenzime të cilat janë të qytetarëve, të taksapaguesve – me dhanë këshilldhënie 800 mijë euro për me ndërtu ose për me shtri rrjetin e ujit pa pasë

ujë – dhe sot ne nuk duhet as me qesh. Kjo logjikë është qesharake. Kjo nuk ka të bëjë as me demokraci, as me ekspertizë. Dhe ne e dimë që mentaliteti juaj ju ka çu me marrë vendime aty për aty, ad hoc, në mes veti, pa asnjë studim, kurse i keni pagu ekspertët përmes njoftësisë apo nuk e di qysh. Por kryesorja: ai ekspert që ka dhënë udhëzime të tilla, për mu nuk e di çfarë lloj eksperti është.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Unë, Labinot, me të vërtetë të kam çmu për si njeri të lexueshëm. Gjithëherë e kam pas një bindje, por në aspektin të cilin po e shtron këtu qaq larg je ti. Në rast se je rritë në demokraci dhe e ke kuptu demokracinë, askush nuk të tha për popullin. Populli është ai që e ka vlerësu: qeky kandidat ka me bë një çerdhe në Sllatin, ka fitu dhe duhet me e bë, se është votu për atë. Ti, i cili ke thanë ka mi bë 20 çerdhe nëpër institucione, kanë thanë: ti prit edhe pak se je para kohe. U kry muhabeti, nuk diskutohet më. Dhe tash ti me 500 vota po do me ja imponu 15 mijë vota të cilat kanë votu qytetarët për këtë koalicion qeverisës që është. Nuk shkon ajo punë. Në rast se jemi në pyetje dhe përgjigje dhe ti shtron tema që dalin pa lidhje, e ta merr mendja që je shumë demokrat se thu "unë po e shtroj". Se nuk e di çka keni bë me 800 mijë euro. Ti e din që aty janë Caritas, ti e din që është KosovaMed, ti e din që është UNDP, AZHR. Dhe e dyta: unë nuk du me hi askënd me lëndu për ata të cilët kanë qeveris. Dhe projekti i cili u zhvillu në Smirë dhe Verbancë, a e din projekt i kujt është? I prindit tënd dhe i ish kryetarit Nexhedin Arifi, dhe ne e kemi vazhdu.

**z.Labinot Bislimi:** Projekti mundet me qenë, se unë jam dakord me projektin: a duhet me shtri rrjetin në Verban, në Smirë, nëpër vende të tjera. Ne jemi dakord në atë pikë, por realizmin ju e keni bë pa e siguru burimin.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** Marrëveshja e cila ka qenë me CDI-në, ne e kemi gjetë: a e din ti këtë punë? Dhe e kemi shty përpapara.

**z.Basri Aliu:** Ne e mbajmë një seancë tjetër me ligjërata politike, se këtu po më duket që po bëhet debat politik dhe nuk ka të bëjë me këtë temë. Dhe distancohem prej disa fjalëve për blerjen e votës. Në qoftë se dikush ka dëshmi, unë e thirri prokurorin tash publikisht edhe këta me i marrë si dëshmitarë që thonë "blerje të votës", dhe le ta dëshmojnë kush e ka ble votën. Ne të shkojmë aty ku e ka vendin. Por jo këtu me shfrytëzu kuvendin me thanë "u blejnë vota".

**z.Hajdin Ademi:** Përshëndejte për të gjithë të prasnihmit. Deshta një pyetje për nënkryetarin, pasi që do të investohen mbi 6 milion euro për ujësjellësin: a do të ketë ujë të pijshëm edhe për fshatin Skifteraj, Remnik, Budrikë, Radivojc.

**z.Jakup Demiri:** Para 4 viteve këto fshatra janë lëshu në ujësjellësin e komunës së Vitisë. Këto i ka promovu komuna: 27 fshatra në komunë të Vitisë kanë ujë të pijshëm dhe i kanë në menaxhim, më duket kanë bë kontrata me Hidromoravën. Dmth ujësjellësit janë të krym, ujë ka veç pine. Te kanalizimi në Smirë e ka nisë Nexhmedin Arifi fazën e parë, pjesën e dytë e ka kry LDK me Sokol Halitin. Berat Kastrati ka qenë mbikëqyrës. Qysh jemi kanë kështu në mbledhje, krejt ka thanë: "as mos më paguaj, veç nale këtë projekt se e merr në qafë një fshat të madh". Në takim kemi qenë krejt. Unë kam qenë prej anëtarëve të këshillit të fshatit Smirë. Veç thashë: ndërpreje këtë projekt, se çka jeni tu bë është gjynah. "As mos më paguaj për kohën që e kam punu, veç ndërpreje, mos e le me u zhvillu këtë projekt". Cili kanalizim në komunë të Vitisë ka pranim teknik? Deri në fund ka qenë kështu. Në fund, qajo mbledhje e fundit që kemi mbajtë si institucione, e masanej keni mbajt do gjëra tinxa dhe i keni bë krejt punët tinxa. Dhe kurrë pranim teknik nuk keni bë, dhe paret ia keni pagu kompanisë 97%. Kjo është e vërteta, nënkryetar. E vërteta po të djegë, por nuk muj me përmbajt, se e kam përfaqësu një fshat, edhe Bekimi ka qenë. Nënkryetar, ti nuk e ke përfaqësu Smirën, veç ja ke bë atë sherr. Tash a po thuani po lidhemi te eksperti që keni pagu me pare? Ai ka thanë: "hiq mos më paguaj, veç nale", dhe ty tu ka drejtu.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i Komunës:** Unë e kam marrë vendimin Jakup me i ndërpre punimet. A i kam ndërpre punimet, po. D.m.th keni ardh ju keni thanë lëshoj punimet. Në rast se gjanë që, unë veq një lëvizje kam bërë për me gjetë një njeri në Smirë me ardh me thanë, lëshoj punimet, unë nuk e shkeli Vitinë.

**z.Jakup Demiri:** Jo, jo, ti i ke gjetë të tjerët. Unë nuk e di çka ke bë ti, me mu më nuk je marrë. Je marrë me disa tjerë. Nënkryetar, unë nuk kam çka me hulumtu. Ti je taku me tjetër, nuk je taku me mu, nuk je taku as me organin që e ke pas mbikëqyrës, që të ka thanë nuk bën. Ta ka lanë punën dhe ka hecë krejt. Cili kanalizim në

krejt komunën e Vitisë? Asnjë nuk ka pranim teknik, as ujësjellësi, as asgjë. Mbi 60% të projekteve nuk kanë pranime teknike, ndërsa pagesat bëhen krejt 90–95%. Në Smirë nuk janë të marrta 12 mijë euro, nuk i ka marrë kompania krejt. Kur ti merr gjysmë milioni euro, për 12 mijë euro a kthehet ai aty a? Po kanalizimi në Smirë nuk ka, se kundërmon. Gjysa e fshatit i vjen era prej atij kanalizimi, prej kësaj pune, prej atij rekomandimit të atij eksperti dhe të atyre muhabeteve që nuk i keni bë. Çka me bë? Unë nuk mundem me thanë diçka që nuk është e vërtetë për atë që jam kanë pjesë e kësaj.

**z.Basri Aliu:** Unë po kërkoj që të zbatohet rregullorja e Kuvenit për pyetje dhe përgjigje, sepse këtu nuk po dihet a janë tu mbajt ligjërata apo pyetje përgjigje. Andaj tu kisha lutë kryesues, zbatoje rregulloren e cilën është miratu prej këtij Kuvendi.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Sa i përket rregullores së Kuvendit dhe praktikës së Kuvendit, nuk e di, Ekrem, a ka sa unë punë në Kuvend. Mirëpo, te pyetjet dhe përgjigjet, në hapësira për diskutimin e problematikave që diskutohet, si kanalizmi, janë në rregull. Deri tash kemi pasë pikë para rendit të ditës dhe e kemi diskutuar këtë formë. Kaniher edhe aspekt politik po i japim, por megjithatë, kur ti qasesh problemit, është çështje normale. Në aspekt politik do të mundohemi me i hiq, por nuk i ikim, se jemi subjekte politike dhe bëjmë pak promovim, se është normale, Basri.

**z.Basri Aliu:** Jo kryesues, nuk pajtohem me këtë qëndrim tëndin, se është decidive atje, pyetje përgjigje. E bënë një pyetje, mund me i dhanë drejtori përgjigjet. I jep, që nuk i jep ja jep me shkrim, dhe e ka minutazhin e caktum, dhe këtu ne ka gjysmë ore po mbajmë ligjërata.

**z.Hasan Aliu nënkryetari i komunës:** Nuk e kemi bisedu atë çështje. Njihere duhet të bëhet ndërtimi i fabrikës, të shikohet mundësia. Besoj që inxhinierat e përpjestojnë sa do të jetë uji për numër të banorëve. E di që do të rritet bukur shumë dhe do të ketë shtypje shumë më shumë, për shkak që rezervari shkonë në oborr të fabrikës që ndërtohet. A do të ketë për ato fshatra, nuk e di, unë do të jem idhtar që duhet me pasë.

**z.Ekrem Abazi:** Unë dashta veç një sqarim drejtorit. Tha që ka fillu me u rregullu shtrati i asaj përrocke, por nuk ka pasë të holla dhe e kanë ndërpre, ose një person e ka ndalu. E tash ka 10 vite që ato dy lagje ujë nuk kemi pasë kurr nëpër abore. Kaniher vjen gati, veç nuk hyn nëpër dhoma, nëpër shtëpia. Aty nuk ka nevojë, se e di që nuk ka financa me shtru shtratin e asaj përrocke, por bile mund të intervenohet në 4–5 vende ku janë zanë, se uji, menjëherë vjen prej beguncës. Vjenë dhe për dy lagjet tona, krejt janë ujë, dmth lagjet tona nëpër abore krejt janë. Unë e di që nuk ka punë shumë dhe nuk ka mundësi me u vonu kjo punë, se e di që ka punë shumë dhe financa që duhet me i dhanë për ato. Por ato mundet me pak investim me largu ujin prej atyre dy lagjeve, se sado pak shi me ra aty, vjen uji.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Pasi që nuk kemi të tjerë për diskutim, faleminderit nga të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

____________________

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

____________________

Гика 2

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
12-03-2026
02-035/02-320

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

Në bazë të nenit 11, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit mbi vetëqeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Repoblikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 13 dhe 8 paragrafi 3, të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrai 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 11.03.2026, bën këtë :

## PROPOZIM VENDIM
## PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEQANT TË PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2026

Neni 1

Me këtë propozim – vendim , propozohet të miratohet Lista e veqant e pronave të palujtshme të Komunës të cilat planifikohet të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Neni 2.

Lista sipas nenit 1 të këtij propozim-vendimi për secilen pronë arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës , të dhënat kadastrale , qellimin e dhënjes në shfrytëzim , destinimi i pronës parashikimi.

Neni 3

Pjesë përberse e këtij propozim vendimi është Lista e veqant e pronave të të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026 përfshirë cartifikaten e pronës dhe kopjen e planit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi dhe procedurat tjera të parapara ,me të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë ne bashkpunim dhe kordinim me Drejtorit tjera të Komunës varsisht fushveprimtarisë përkatëse. Zyra e Kryetarit të Komunës , Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
12-03-2026
02-035/02-321

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

LISTA E VEQANT E PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHET PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJAT VITIT 2026.

| Nr | Të dhënat kadastrale të pronës | Arsyetimi i interest publik dhe zhvillimi ekonomik | Destinimi | Periudha kohore për dhënjen në shftytëzimtë pronës së palujtshme |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Njësisë kadastrale P-70101023-00991-0 në sipërfaqe prej 33358 $m^2$, Njësisë kadastrale P-70101023-01576-0 në sipërfaqe prej 10553 $m^2$, Njësisë kadastrale P-70101023-01005-0 në sipërfaqe prej 38424 $m^2$, Pjesen prej 100000$m^2$ të njësisë kadastrale P-70101023-01577-0 në sipërfaqe prej 142999 $m^2$ në zonën kadastrale në Zhiti | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |
| 2. | Njësisë kadastrale me numër:<br>P-70101018-00175-0, në sip.211198 $m^2$,<br>P-70101018-00197-0, në sip. 96342 $m^2$,<br>P-70101018-00200-0, në sip. 130577 $m^2$,<br>P-70101018-00211-3, në sip. 110000 $m^2$.<br>në zonën kadastrale në Devajë. | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Pyjore<br>Pyjore<br>Pyjore<br>Bujqësore | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatgjat. |
| 3. | P-70101038-01724, pjesa prej 18234 $m^2$ nga siperfaqja e përgjithshme prej 27665 $m^2$, në vendin e quajtur "Rashiq në zonën kadastrale në Smirë. | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për bujqësor a të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë | Pyjore | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter |
| 4. | Pjesën prej 300$m^2$ të njësisë kadastrale P-70101005-00630-0, nga sipërfaqe e përgjithshme prej 13282$m^2$, Toka bujqsore , kullosë e klasit të 5, në vendin e quajtur " Zabel"në zonën kadastrale në Terpezë | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës. | Bujqësore | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |
| 5. | Njësisë kadastrale P-70101021-00470-0 në sipërfaqe prej 4740 $m^2$, Toka bujqësore në vendin e quajtur "Rosulja Kod G Drobesha" | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e të hyrave. | Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për tregun e kafshëve | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | Njësisë kadastrale P-70101040-01784-1 në sipërfaqe prej 37151 m², Toka pyjore në vendin e quajtur "Zhar zhar" Njësia kadastrale P-70101040-01785-0 në sipërfaqe prej 3968 m², në zonën kadastrale në Sadovinë e Çerkezëve | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Zona industriale | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |
| 7. | Njësisë kadastrale P-70101003-01840-0 në sipërfaqe prej 8900 m², Toka bujqësore në vendin e quajtur "Meçevac" Njësisë kadastrale P-70101003-01846-0 në sipërfaqe prej 14910 m², Toka bujqsore në vendin e quajtur "Meçevac", Njësisë kadastrale P-70101003-01607-2 në sipërfaqe prej 32552 m², Toka jo pjellore në vendin e quajtur "Malishte", në zonën kadastrale në Binçë | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Pyjore | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatgjatë |
| 8. | Njësisë kadastrale P-70101037-01813-0 në sipërfaqe prej 1737 m², Toka bujqësore në vendin e quajtur "Sllanishte"dhe Njësisë kadastrale P-70101037-01790-0 në sipërfaqe prej 3791 m², Toka bujqësore në vendin e quajtur "Sllanishte" në zonën kadastrale në Sllatinë. | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë | Bujqësore | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |

Me datën 10.03.2026, Viti.

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning***

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : Komuna e Vitisë

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **176/2026** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 11.03.2026 - 08:28 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | VITI / VITINA / VITI |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | VITI / VITINA / VITI |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name | Emri Ime First Name | Emri i babait Ime oca Father's Name | Gjinia Pol Gender | Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Vitisë | | | / / | **600424486** | KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO | | 29.12.2020 | |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Adresa tjetër Druga adresa Other address | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| / / | | 28 NËNTORI | | |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## 3. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit | Komuna / Opština / Municipality | Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone | Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type | Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind | Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number | Vendi i quajtur Zvano mesto Place name | Sipërfaqja Površina Area | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| -70101023-00991-0 | VITI / VITINA / VITI | Zhiti / Žitinje / Zhiti | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | DEVAJSKE ROVINE / DEVAJSKE ROVINE / DEVAJSKE ROVINE | **33358** | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 6 (33358 m²) / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / / | **1 / 1** | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| -70101023-01005-0 | VITI / VITINA / VITI | Zhiti / Žitinje / Zhiti | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | MERAJA / MERAJA / MERAJA | **38424** | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 6 (38424 m²) / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / / | **1 / 1** | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| -70101023-01576-0 | VITI / VITINA / VITI | Zhiti / Žitinje / Zhiti | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | GOLESH / GOLESH / GOLESH | **10553** | Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 8 (10553 m²) / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 8 Klase / / Agriculture - Arable - 8th Class Arable Land / / | **1 / 1** | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70101023-01577-0** | VITI / VITINA / VITI | Zhiti / Žitinje / Zhiti | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | GOLESH / GOLESH / GOLESH | **142999** | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 5 (77313 m²) / Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 6 (65686 m²) / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 5 Klase / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / / | **1 / 1** | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| | | | | | | **Totali i sipërfaqes së parcelave:** | **225334** | | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /*
*Ministry of Environment and Spatial Planning*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : Komuna e Vitisë

| | |
|---|---|
| ʼumri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 176/2026 |
